



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 51

2003

Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9066 datë 15.5.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për mbrojtjen shoqërore”.....	1995
Ligj nr.9067 datë 15.5.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Belgjikës për transportin ajror”.....	2006
Ligj nr.9068 datë 15.5.2003	Për ratifikimin e “Konventës europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale”.....	2017
Ligj nr.9069 datë 15.5.2003	Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	2034
Vendim i KM nr.216, datë 10.4.2003	Për miratimin e dokumentit të strategjisë kombëtare të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit.....	2040
Vendim i GJK nr.19, datë 12.6.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.5, datë 1.2.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.21, datë 7.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese	2040

L I G J
Nr.9066, datë 15.5.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për mbrojtjen shoqërore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3838, datë 17.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË TURQISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë kanë rënë dakord për pikat e mëposhtme në fushën e mbrojtjes shoqërore.

PJESA I
DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

1. Në këtë Marrëveshje:

1.1 “Vend” do të thotë, në lidhje me Republikën e Shqipërisë, Republika e Shqipërisë dhe në lidhje me Republikën e Turqisë, Republika e Turqisë.

1.2 “Legjislacion” do të thotë ligj, sipas ligjit dhe rregullore të përcaktuara në nenin 2.

1.3 “Përfitim” do të thotë, në lidhje me një palë, përfitim në para, pension ose shpërblim, për të cilin ka një dispozitë në legjislacionin e asaj pale, duke përfshirë çdo shumë shtesë apo rritje të atij përfitimi, pensioni ose shpërblimi.

1.4 “Autoritet kompetent” do të thotë, në lidhje me Republikën e Shqipërisë, Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, ministrat ose autoritetet e tjera korrespondues përgjegjës për degët dhe skemat e mbrojtjes shoqërore në të gjithë ose në pjesë të veçanta të territorit të saj dhe në lidhje me Republikën e Turqisë, Ministri i Punës dhe Sigurimit Shoqëror, ministrat ose autoritetet e tjera korrespondues përgjegjës për degët dhe skemat e mbrojtjes shoqërore në të gjithë ose në pjesë të veçanta të territorit të saj.

1.5 “Institucion kompetent” do të thotë institucioni ose organizata përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të përmendur në nenin 2.

1.6 “Periudhë sigurimi” do të thotë periudha gjatë së cilës janë paguar kontribute për sigurime shoqërore ose periudhat për të cilat është gjykuar se janë paguar kontribute.

1.7 “Person i siguruar” do të thotë personat që janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të përmendur në nenin 2.

1.8 “Anëtar i familjes” do të thotë çdo person i parashikuar si i tillë nga legjislacioni, aplikuar nga institucionet e palëve.

1.9 “Rezidencë” do të thotë rezidenca e zakonshme.

1.10 “Rezidencë e përkohshme” do të thotë vendi ku një person, i cili zakonisht banon në territorin e një pale, banon gjatë qëndrimit të tij/saj të përkohshëm në territorin e palës tjetër.

2. Çdo term, që nuk është përcaktuar në këtë nen, do të ketë kuptim të përcaktuar për të në legjislacionin që aplikohet.

Neni 2

Hapësira ligjore

1. Kjo Marrëveshje do të aplikohet sipas legjislacionit të mëposhtëm:

a) Në lidhje me Republikën e Turqisë:

a.1. ligji i sigurimeve shoqërore që mbulon punëtorët dhe ligji i sigurimeve shoqërore për punëtorët e bujqësisë;

a.2. ligji i fondit të pensioneve të Republikës së Turqisë që mbulon punonjësit shtetërorë (invaliditet, pleqëri dhe në rastet e humbjes së mbajtësit të familjes);

a.3. ligji i Institucionit të Sigurimeve Shoqërore për tregtarët, artizanët dhe të vetëpunësuarit e tjerë, si dhe ligji i sigurimeve shoqërore për personat e vetëpunësuar në bujqësi.

a.4. legjislacioni lidhur me fondin e pensioneve siç përcaktohet në nenin 20 të ligjit të Sigurimeve Shoqërore 506;

b) Në lidhje me Republikën e Shqipërisë:

b.1. legjislacioni i sigurimeve shoqërore (sëmundje dhe barrëlindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, invaliditet, pension pleqërie dhe familjar) që mbulon personat e punësuar, si dhe personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit);

b.2. legjislacioni lidhur me përfitimet familjare;

b.3. legjislacioni lidhur me sigurimin shëndetësor;

b.4. legjislacioni lidhur me kujdesin shëndetësor.

2. Kjo Marrëveshje do të aplikohet, gjithashtu, sipas ligjeve dhe rregullave të cilat amendojnë, kombinojnë ose pasojnë legjislacionin e specifikuar në paragrafin 1, me kusht që termat e paragrafit 3 të rezervohen.

3. Kjo Marrëveshje do të aplikohet sipas ligjeve dhe rregullimeve, të cilat e shtrijnë hapësirën e legjislacionit të një pale në kategori të reja përfituesish dhe përcaktojnë përfitime të reja, nëse Palës tjetër nuk i është komunikuar ndonjë ndryshim brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ligjeve dhe rregullimeve.

4. Kjo Marrëveshje do të aplikohet në legjislacionin lidhur me një degë të re të sigurimeve shoqërore me kushtin që ndërmjet palëve të jetë përfunduar një marrëveshje për këtë qëllim.

Neni 3

Hapësira personale

Kjo Marrëveshje do të aplikohet për personat, të cilët janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të Republikës së Turqisë dhe të Republikës së Shqipërisë dhe të personave që kanë humbur mbajtësin e familjes dhe anëtarëve të varur të familjes që mbulohen nga legjislacioni i secilës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 4

Trajtim i barabartë

Të gjithë personat e përcaktuar në nenin 3 do të kenë trajtim të barabartë përsa i përket të

drejtave dhe detyrimeve sipas legjislacionit të secilës palë.

Neni 5 **Transferimi i përfitimeve**

Kur nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje:

1. Përfitimet që do t'i paguhen në bazë të legjislacionit të njëres palë çdo personi të përcaktuar në nenin 3, si dhe ato që jepen në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të paguhen në territorin e palës tjetër dhe nuk i nënshtrohen ndonjë zbritjeje, ndryshimi, pezullimi ose sekuestrimi për shkak të rezidencës së personit në territorin e palës tjetër.

2. Përfitimet që do të paguhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje, do t'i paguhen gjithashtu një personi në një vend të tretë, i cili është apo ka qenë subjekt i legjislacionit të të dyja palëve, ose personave në varësi të tij/saj, ose atyre që kanë humbur mbajtësin e familjes sipas rastit.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk aplikohen për përfitimet e mëposhtme:

a) përfitime për papunësi;

b) përfitime të veçanta të dhëna si ndihmë ekonomike ose në rast nevojë.

PJESA II **DISPOZITA LIDHUR ME LEGJISLACIONIN E APLIKUESHËM**

Neni 6 **Rregullat për mbulimin**

1. Me kusht që termat e mëposhtëm të kësaj Marrëveshjeje rezervohen:

1.1 Një person i punësuar në territorin e njëres palë, është subjekt i vetëm i legjislacionit të asaj pale që i përket punës së tij/saj.

1.2. Një person, i cili ka rezidencën e tij të përhershme në territorin e njëres palë dhe që ka një aktivitet në emër të tij/saj në territorin e palës tjetër ose në territorin e të dyja palëve, do të jetë subjekt i vetëm i legjislacionit të palës, në territorin e së cilës ai ka rezidencën.

2. Një person i cili është subjekt i legjislacionit të njëres Palë, por që dërgohen në territorin e palës tjetër për të punuar për më pak se 24 muaj, do të jetë subjekt i legjislacionit të palës së parë sikur ai punon në territorin e asaj pale. Periudha prej 24 muajsh mund të shtrihet deri në 60 muaj me aprovimin e mëparshëm të autoriteteve kompetente të të dyja palëve.

3. Atje ku ekuipazhi i një anijeje është subjekt i legjislacioneve të të dyja palëve pa aplikimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, ekuipazhi i punësuar në bordin e një anijeje me flamur turk i nënshtrohet legjislacionit turk, përsa i përket asaj pune, dhe ekuipazhi i punësuar në bordin e një anijeje me flamur shqiptar i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, përsa i përket asaj pune.

4. Personat e punësuar në territorin e një pale si agjentë të qeverisë së palës tjetër do të jenë subjekt i legjislacionit të palës që e punëson, në rast se ata janë subjekt të asaj pale. Megjithatë, në rast se ata janë subjekte të palës, në territorin e së cilës ata janë punësuar ose kanë rezidencën e përhershme në atë territor, ata mund të kërkojnë aplikimin e legjislacionit të asaj pale. Kjo zgjedhje nuk do të aplikohet në mënyrë retrospektive.

5. Autoritetet kompetente të të dyja palëve mund të paraqesin ndryshime të rregullave të zbatimit për ndonjë person apo grupe me marrëveshje reciproke.

PJESA III **DISPOZITA LIDHUR ME PËRFITIMET**

SEKSIONI 1 **BASHKIMI I PERIUDHAVE**

Neni 7

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Kur njohja, ruajtja apo dhënia më pas e së drejtës për përfitim sipas legjislacionit të një prej Palëve Kontraktuese është subjekt i plotësimit të periudhës së sigurimit, institucioni kompetent i Palës Kontraktuese merr në konsideratë periudhat e sigurimit sikur ato të ishin plotësuar në bazë të legjislacionit të tyre, për aq sa këto periudha nuk përputhen.

2. Në përcaktimin e kushteve, lidhur me fillimin e punës për herë të parë, do të merren parasysh ruajtja ose njohja e së drejtës për një përfitim, periudhat e sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese dhe data e fillimit të punës.

Neni 8

Periudhat e plotësuar sipas legjislacionit të një vendi të tretë

Kur një person nuk plotëson kushtet për të marrë një përfitim sipas legjislacionit të të dyja palëve mbi bazën e periudhave të bashkuara të sigurimit, që përcaktohen në dispozitat e nenit 7, çështja e së drejtës për përfitim do të zgjidhet duke marrë parasysh periudhat e sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të një vendi të tretë me të cilin të dyja Palët Kontraktuese kanë arritur një marrëveshje për sigurimet shoqërore për bashkimin e periudhave të sigurimit.

Neni 9

Zgjatja minimum e periudhave që bashkohen

Pa paragjykitime lidhur me ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshjeje, kur zgjatja totale e periudhave të sigurimit e plotësuar nga një person sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese është më pak se një vit dhe kur nuk ekziston e drejta për përfitim sipas atij legjislacioni mbi bazën e atyre periudhave, nuk mund të pretendohet që për këto periudha të jepet një përfitim nga institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese në zbatim të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, këto periudha do të merren në konsideratë nga Pala tjetër Kontraktuese, ndërsa përcakton të drejtën për përfitim në përputhje me legjislacionin e aplikuar.

SEKSIONI 2

PËRFITIMI PËR SËMUNDJE DHE BARRËLINDJE

Neni 10

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Kur njohja, ruajtja ose rifitimi i së drejtës për përfitim për sëmundje ose barrë lindje sipas legjislacionit të një Palë Kontraktuese është subjekt i plotësimit të periudhave të sigurimit ose të punësimit, institucioni kompetent i një Palë Kontraktuese do të marrë në konsideratë periudhat e sigurimit ose punësimit të plotësuar sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, sikur ato të jenë plotësuar sipas legjislacionit të Palës së parë Kontraktuese.

Neni 11

Përfitimet mjekësore

1. Kur kushtet e një shqiptari të siguruar dhe që është punësuar në Turqi përkohësisht në një projekt të veçantë prej punëdhënësve të tij/saj të vazhdueshëm dhe të anëtarëve të familjes së tij/saj që banojnë me të apo të një turku të siguruar, të punësuar po ashtu në Shqipëri dhe të anëtarëve të familjes së tij/saj kërkojnë trajtim mjekësor urgjent, ata do të marrin përfitim për sëmundje ose barrë lindje, duke përfshirë edhe shtrim në spital, për llogari të Palës Kontraktuese ku është qendra kryesore e biznesit.

2. Kur kushtet e punëtorëve të regjistruar si të siguruar sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese dhe të anëtarëve të familjes që banojnë me ta kërkojnë trajtim mjekësor urgjent gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ata do të marrin përfitime për

sëmundje dhe barrë lindje, duke përfshirë dhe shtrim në spital për llogari të Palës Kontraktuese ku ata janë të regjistruar si të siguar.

3. Kur punëtorët e regjistruar si të siguar sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese dhe anëtarët e familjes që banonjnë me ta, transferohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ndërsa marrin përfitime për sëmundje ose barrë lindje nga institucionet e sigurimeve shoqërore turke ose shqiptare, ata do të vazhdojnë t'i marrin këto përfitime. Megjithatë, përfituesi duhet të marrë autorizimin e institucionit kompetent para transferimit. Kërkesa për autorizim do të refuzohet vetëm mbi bazën e një raporti mjekësor dorëzuar atij institucioni në rast se gjendja shëndetësore e personit në fjalë nuk lejon transferimin e tij/ saj në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Autorizimi mund të jepet në vazhdim, edhe nëse nuk është marrë më parë nga forca madhore.

4. Njohja e së drejtës për të përfituar do të përcaktohet në zbatim të legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është punësuar i siguruari, ndërsa anëtarët e familjes, shtrirja e përfitimeve dhe dispozitat e tyre do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese të vendbanimit të përkohshëm ose të përhershëm.

5. Anëtarët e familjes së një personi, të cilit i takon një përfitim në bazë të legjislacionit të një Pale Kontraktuese sipas së cilës ai/ajo është i/e regjistruar si i/e siguar, do të marrin përfitime mjekësore nga dega e sigurimit për sëmundje dhe barrë lindje, nëse nuk përfitojnë nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës ata banojnë.

6. Kur anëtarët e familjes transferohen në territorin e institucionit kompetent, ata marrin përfitime sipas dispozitave të legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese. Kjo dispozitë aplikohet edhe në rastet kur anëtarët e familjes tashmë kanë filluar të marrin përfitime për të njëjtën rast sëmundjeje ose barrë lindjeje nga institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese para transferimit. Nëse në këtë rast përcaktohet një kohë kufi për dhënien e përfitimeve mjekësore nga legjislacioni i aplikueshëm i atij institucioni kompetent, atëherë merren në konsideratë periudhat, gjatë të cilave janë dhënë përfitimet para transferimit.

7. Shpenzimet për përfitime përballohen nga Pala Kontraktuese në të cilën personi në fjalë është regjistruar si i siguar.

Neni 12

Përfitimet shëndetësore për pensionistët

1. Kur një person, të cilit i është dhënë një pension ose përfitim në para në përputhje me legjislacionin e të dyja Palëve Kontraktuese me kusht bashkimit e periudhave të sigurimit të plotësuar në të dy Palët Kontraktuese, bashkë me familjen e tij/saj, ka fituar të drejtën e përfitimeve mjekësore sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ai/ajo është rezident, përfitimet do të mbulohen nga institucioni i palës ku personi ka rezidencën dhe në përputhje me legjislacionin që ai institucion aplikon.

2. Kur një personi i është dhënë një pension ose përfitim në para sipas legjislacionit vetëm të njëjës prej Palëve Kontraktuese, dhe është rezident në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përfitimet mjekësore që janë njohur si e drejtë në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese përgjegjëse për pagesën e pensionit për personin e siguar dhe anëtarët e familjes së tij/saj, do të jepen nga vetë institucioni i vendit të rezidencës, në emër dhe me shpenzimet e institucionit kompetent të Palës Kontraktuese, përgjegjëse për atë pension.

3. Kur personat të cilët marrin pensione ose përfitime sipas legjislacioneve të të dyja Palëve Kontraktuese dhe ata persona që marrin pensione ose përfitime sipas legjislacionit vetëm të një prej Palëve Kontraktuese, si dhe anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta marrin rezidencë të përkohshme në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kur kushtet e tyre do të kërkojnë një trajtim urgjent, ata do të marrin përfitime mjekësore me shpenzimet, në rastin e parë, të institucionit kompetent të palës ku janë rezidentë të përhershëm dhe, në rastin fundit, të institucionit kompetent të palës përgjegjëse për pagesën e pensionit.

4. Njohja e së drejtës për këto përfitime, për ata të cilët marrin pensione nga të dyja palët, do të vendoset në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës përfituesi është rezident i përhershëm, dhe në rastin kur përfituesi merr pension vetëm nga njëra palë, do të vendoset në përputhje me legjislacionin e asaj Pale Kontraktuese. Hapësira, kohëzgjatja dhe mënyra e dhënies së përfitimeve do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin e vendit në territorin e të cilit

përfituesi është rezident.

Neni 13

Përfitimet kryesore shëndetësore dhe përfitimet e para

1. Dhënia e përfitimeve mjekësore jetësore për ata që kanë fituar të drejtën e përfitimit mjekësor në përputhje me nenet 11,12/2-3 të kësaj Marrëveshjeje, do të kushtëzohet nga autorizimi i institucionit kompetent për këtë qëllim, me përjashtim të rasteve të një emergjence absolute.

2. Pagesa e përfitimeve në para (shpërblim ditor) do të bëhet në përputhje me legjislacionin e institucionit ku personi në fjalë është regjistruar.

Neni 14

Rimbursimi i kostos së përfitimeve shëndetësore

Shpenzimet për kujdes shëndetësor, të dhëna për rastet e parashikuara nga nenet 11,12,13,15,18,19 dhe 20 të kësaj Marrëveshjeje, do të rimbursohen nga institucioni ku personi në fjalë është regjistruar në institucionin kompetent, i cili do të japë përfitimet sipas procedurave që do të përcaktohen nga Marrëveshja Administrative.

Neni 15

Përfitimet për barrë lindje

Kur personi i siguruar ose një nga anëtarët e familjes së tij fiton të drejtën e përfitimit për barrë lindje sipas legjislacionit të një ose të të dyja Palëve Kontraktuese, do të aplikohen vetëm dispozitat e legjislacionit të vendit ku personi kalon periudhën e barrë lindjes, duke marrë parasysh, kur është e nevojshme, periudhat e sigurimit që do të bashkohen sipas nenit 10.

Përfitimet mjekësore për një person, që ka fituar të drejtën e përfitimit për barrë lindje, do të jepen sipas kërkesave në përputhje me nenet 11,12 dhe 13 të kësaj Marrëveshjeje.

SEKSIONI 3

SHPENZIME PËR FUNERALET

Neni 16

1. Kur një person i regjistruar si i siguruar në bazë të legjislacionit të njëjës prej Palëve Kontraktuese vdes në territorin e palës tjetër, ai/ajo do të fitojë të drejtën e përfitimit të shpenzimeve funerale sikur ai/ajo të ketë vdekur në territorin e palës ku ai/ajo është siguruar.

2. Kur në aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, dispozita për shpenzimet për funerale sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese është e lejueshme, do të jepet sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ka ndodhur vdekja.

3. Kur vdekja ndodh jashtë territorit të të dyja Palëve Kontraktuese, grantet për shpenzimet funerale do të jepen sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese, në bazë të legjislacionit të së cilës i vdekuri është regjistruar si i siguruar së fundi.

4. Kur në kohën e vdekjes, periudha e sigurimit për të fituar të drejtën e marrjes së këtij përfitimi nuk është plotësuar, periudhat e sigurimit të plotësuara në të kaluarën në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të merren parasysh në mënyrë që të plotësojnë periudhat e plotësuara në territorin e palës së parë.

SEKSIONI 4

PËRFITIM INVALIDITETI, PENSION PLEQËRIE DHE PAGESË NË RAST VDEKJEJE

Neni 17

Llogaritja e masës së përfitimit që duhet të jepet

1. Kur personi fiton të drejtën për pension sipas legjislacionit vetëm të njërës Palë Kontraktuese, një pension i vetëm do të akordohet, pa marrë parasysh periudhat e sigurimit të plotësuar në Palën tjetër Kontraktuese.

2. Kur dhënia e së drejtës për një pension të vetëm sipas legjislacionit vetëm të njërës prej Palëve Kontraktuese nuk është e lejueshme, por një e drejtë për pension mund të jepet vetëm duke marrë parasysh periudhat e plotësuar sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e mëposhtme do të aplikohen:

2.1 Në llogaritjen e masës së pensionit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore i secilës Palë Kontraktuese do të marrë parasysh periudhat e mbedhura të sigurimit, sikur këto periudha të ishin plotësuar vetëm sipas legjislacionit të vet.

2.2 Institucioni kompetent, atëherë, përcakton masën e pensionit që duhet të jepet duke aplikuar raportin midis periudhave të sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese me masën e llogaritur teorikisht sipas nënparagrafit 2.1 të këtij neni.

3. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje duhet të merren parasysh dispozitat e legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese që përcaktojnë reduktimin, ndërprerjen ose heqjen e pensionit.

SEKSIONI 5

AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 18

Përfitimet në lidhje me aksidentet në punë

1. Rritjet dhe shtesat e granteve të dhëna për aksidente në punë, sipas legjislacionit të secilës prej Palëve Kontraktuese, do të vazhdojnë të paguhen pasi personat e interesuar transferohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Kur një person që ka pësuar aksident në punë ose vuan nga sëmundje profesionale në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese, transferon rezidencën e tij/saj në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, në vijim të marrjes së përfitimeve të dhëna gjatë periudhës së paaftësisë së përkohshme, ai/ajo do të vazhdojë t'i marrë këto përfitime me autorizim të institucionit kompetent para largimit.

Kur kushtet e personit që ka pësuar aksident në punë ose vuan nga sëmundje profesionale bëjnë të domosdoshme autorizimin në datën e skadencës, kjo zgjatet deri sa personi të shërohet, duke iu nënshtruar komisionit mjekësor dhe lejes së institucionit kompetent.

3. Kur gjendja e personit të aksidentuar në punë ose që vuan sëmundje profesionale, keqësohet në vijim të transferimit të rezidencës së tij/saj në territorin e Palës tjetër ai/ajo që fiton të drejtën për kujdes shëndetësor të dhënë në raste aksidentesh në punë, me kusht që personi të marrë autorizimin e institucionit në të cilin ai/ajo është regjistruar, në datën e ndodhjes së aksidentit ose të përcaktimit fillestar të diagnozës.

4. Kujdesi shëndetësor i përcaktuar në nënparagrafin 2 dhe 3 të këtij neni do të jepet nga institucioni i vendit ku personi ka pasur rezidencën e fundit dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit të aplikueshëm këtu në lidhje me hapësirën dhe mënyrën e dhënies së këtij kujdesi. Përsa i përket rasteve të treguara në nënparagrafin 2 të këtij neni, përfitimet në para (shpërblime ditore) jepen nga institucioni në të cilin personi është regjistruar dhe në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për të.

5. Shpenzimet e përfitimeve të dhëna në rastet e parashikuara në nënparagrafët 2 dhe 3 të këtij neni do të mbulohen nga institucioni në të cilin punëtori është regjistruar. Mënyra e pagimit të shpenzimeve për kujdes shëndetësor nga institucioni në të cilin punëtori është regjistruar, institucionit në vendin e fundit të rezidencës, përcaktohet nga Marrëveshja Administrative.

6. Për situatat e përshkruara në nënparagrafët 2 dhe 3 të këtij neni, dhënia e pajisjeve të rëndësishme dhe përfitimeve mjekësore, siç tregohet në aneksin e Marrëveshjes Administrative, do të kushtëzohen nga autorizimi i institucionit kompetent për këtë qëllim, me përjashtim të rasteve të emergjencës.

7. Në përcaktimin e shkallës së invaliditetit, si pasojë e një aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale në përputhje me legjislacionin e një Pale Kontraktuese, do të merret parasysh çdo aksident ose sëmundje e mëparshme sipas legjislacionit të palës tjetër, sikur ato të kenë ndodhur dhe të jenë shfaqur sipas legjislacionit të palës së parë.

Neni 19

Përfitime në lidhje me sëmundjet profesionale

1. Kur personi me sëmundje profesionale ka punuar në territorin e të dyja palëve në punë që mund të shkaktojnë të tilla sëmundje, përfitimet që kërkohen nga i siguruari ose personat e varur prej tij/saj do të caktohen në përputhje me legjislacionin e palës, në territorin e së cilës aktiviteti në fjalë është kryer, me kusht që kërkesat e këtij legjislacioni të plotësohen.

2. Kur legjislacioni i një prej palëve kushtëzon të drejtën e përfitimeve për sëmundje profesionale me diagnozën e vet fillestare në territorin e vet, ky kusht do të plotësohet, nëse sëmundja diagnostikohet së pari në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Rregullat e mëposhtme do të aplikohen kur gjendja e personit që është trajtuar sipas legjislacionit të një pale për sëmundje profesionale keqësohet gjatë kohës kur ai/ajo është rezident në territorin e palës tjetër.

3.1 Kur personi nuk ka punuar në territorin në të cilin ai/ajo është aktualisht i angazhuar në një punë, që ka shkaktuar sëmundjen profesionale ose keqësimin e saj, institucioni i palës së parë në të cilën personi është regjistruar do të realizojë dhënien e përfitimeve sipas legjislacionit të vet, duke marrë parasysh shkallën e keqësimit.

3.2 Kur personi ka punuar në territorin në të cilin është aktualisht i angazhuar në një punë, që ka shkaktuar sëmundjen profesionale ose ka keqësimin e saj, institucioni i palës së parë në të cilën personi është regjistruar do të realizojë dhënien e përfitimeve sipas legjislacionit të vet, pa marrë parasysh shkallën e keqësimit. Institucioni i palës në rezidencën aktuale do të japë përfitim suplementar, masa e të cilit është e barabartë me diferencën midis masës që duhet të llogaritet sipas legjislacionit të vet, duke marrë parasysh shkallën e acarimit dhe shumën për t'u llogaritur sikur të ishte rasti që sëmundja profesionale të ketë ndodhur në territorin e vet para acarimit.

SEKSIONI VI

KONTROLI ADMINISTRATIV DHE MJEKËSOR

Neni 20

1. Kur personat të konsideruar nga legjislacioni i një pale si të papërshtatshëm për punë për shkak të invaliditetit, aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale janë rezident në territorin e palës tjetër, kontrollet administrative dhe mjekësore që zbulojnë shkallën e invaliditetit të tyre në mënyrë që të mundësohet vazhdimësia e së drejtës për sigurim shoqëror, do të kryhen nga institucioni kompetent i palës së fundit me kërkesë të institucionit të palës së parë.

Megjithatë institucioni kompetent i palës së parë do të rezervojë të drejtën e rikontrollimit të personit nga një specialist ose në vendin ku personi është rezident, ose në vendin e vet. Në rastin e fundit, shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit mbulohen nga institucioni që kërkoi riekzaminimin.

2. Shpenzimet e riekzaminimit paguhen nga institucioni që e kërkoi atë, në përputhje me metodën dhe parimet e përcaktuara në Marrëveshjen Administrative.

PJESA IV

DISPOZITA ADMINISTRATIVE DHE TË PËRGJITHSHME

Neni 21

Rregullimi administrativ

Një Marrëveshje e Përgjithshme Administrative, që arrihet midis autoriteteve kompetente të palëve, do të përcaktojë parimet e kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, ato që kanë lidhje me dispozitat që përmbajnë referenca të qarta për Marrëveshjen Administrative. Institucionet kompetente ndërlidhëse të palëve do të përcaktohen nga kjo Marrëveshje Administrative.

Në zbatim të metodave dhe parimeve, format përkatëse, të cilat do të përcaktohen reciprokisht nga palët, do t'i aneksohen kësaj Marrëveshjeje të Përgjithshme Administrative ose ku është e nevojshme, një Marrëveshje Administrative shtesë.

Neni 22

Shkëmbimi i informacionit dhe asistenca reciproke

1. Autoritetet dhe institucionet kompetente përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje:

1.1 Do t'i komunikojnë njëra-tjetrës, për sa kohë e lejon legjislacioni i tyre, të gjithë informacionin për masat e marra prej tyre për aplikimin e kësaj Marrëveshjeje.

1.2 Do të asistojnë njëra-tjetrën në përcaktimin dhe dhënien e së drejtës që rrjedh nga aplikimi i kësaj Marrëveshjeje ose nga legjislacioni sipas të cilit kjo Marrëveshje aplikohet, sikur kjo të ishte një çështje e aplikimit të legjislacionit të tyre.

1.3 Do t'i komunikojnë njëra-tjetrës, në kohën më të afërt të përshtatshme, të gjithë informacionin për masat e marra prej tyre për aplikimin e Marrëveshjes ose për amendamentet në legjislacionin kombëtar për sa kohë që këto ndryshime kanë efekt në zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

2. Ndihma e dhënë sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.2 të këtij neni, do të jetë falas, nëse nuk përcaktohet ndryshe në Marrëveshjen Administrative, së cilës i referohemi në nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje për qëllim rimbursimi të kategorive të caktuara të shpenzimeve. Institucioni kompetent i një pale do të tregojë masën që duhet të paguhet me monedhën e palës së fundit, ndërsa i komunikon palës tjetër kërkesë për pagesë.

3. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin e një pale, çdo informacion për një individ, i komunikuar në përputhje me dhe për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje për palën tjetër nga pala tjetër, do të jetë konfidencial dhe do të përdoret vetëm për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe legjislacionit sipas të cilit kjo Marrëveshje aplikohet.

Neni 23

Përfjashtimi ose reduktimi nga taksat, tatimet dhe shpenzimet

1. Reduktimi ose përfjashtimi nga taksat, tatimet, shpenzimet konsullore dhe kostot administrative, të përcaktuara nga legjislacioni i një pale, për nxjerrjen e një certifikate ose dokumenti, të kërkuar nga legjislacioni i asaj pale, do të aplikohet për certifikatat apo dokumentet e kërkuara nga legjislacioni i palës tjetër.

2. Të gjitha dokumentet formale të kërkuara për qëllim aplikimi të kësaj Marrëveshjeje do të përfjashtohen nga autenticiteti i autoriteteve diplomatike dhe konsullore.

Neni 24

Gjuha që përdoret në komunikim

Për qëllimet e aplikimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet dhe institucionet kompetente të palëve do të komunikojnë direkt në gjuhën zyrtare të secilës palë.

Neni 25

Dorëzimi i kërkesave, deklarimeve dhe apelet

1. Çdo deklaratë, kërkesë ose apelim, në lidhje me përcaktimin e një të drejte për përfitim, e cila për qëllimet e legjislacionit të një pale i është nënshtruar autoritetit ose institucionit kompetent të asaj pale, brenda limiteve ligjore kohore, do të konsiderohet sikur t'i ishte nënshtruar autoritetit ose institucionit kompetent të palës tjetër. I njëjti parim është i aplikueshëm edhe për peticionet, deklaratat, apelimet për çështje të ndryshme.

2. Nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, çdo kërkesë për përfitim, sipas legjislacionit të një palë, do të konsiderohet si pretendim për përfitimin përkatës sipas legjislacionit të Palës tjetër, me kusht që aplikuesi:

2.1 të ketë treguar në peticionin e tij/saj që pretendimi i tij/saj është gjithashtu i përkueshëm sipas legjislacionit të palës tjetër ose

2.2 të ketë dhënë informacion dhe dokumente që tregojnë periudha të besueshme të sigurimit

sipas legjislacionit të palës tjetër.

Dispozitat e mësipërme nuk do të aplikohen nëse aplikanti kërkon qartë në petitionin e tij/saj shtyrjen e vendimit në lidhje me dhënien e së drejtës.

3. Në rastet ku dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni aplikohen, autoriteti ose institucioni kompetent, që pranon pretendimin, deklarimin ose apelimin, ia kalon atë pa vonesë autoritetit ose institucionit kompetent të palës tjetër.

Neni 26

Pagimi i përfitimeve

Institucioni kompetent i një pale mund të zgjedhë të shkarkojë detyrimin e vet që rrjedh nga aplikimi i kësaj Marrëveshjeje, në monedhën e palës së dytë.

Neni 27

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese përpiqen të bien dakord për ndryshimet që rrjedhin nga interpretimi ose aplikimi i kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet negociatave.

2. Nëse ndonjë mosmarrëveshje nuk zgjidhet në këtë mënyrë brenda një periudhe gjashtëmuajore, të dyja palët i drejtohen arbitrazhit, i cili do të ngrihet duke ndjekur hapat e mëposhtme:

2.1 Çdo Palë Kontraktuese delegon një person arbitër brenda një muaji nga marrja e njoftimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga arbitrazhi. Të dy personat e ngarkuar për arbitrazh delegojnë një arbitër të tretë që nuk duhet të jetë bashkëkombas i palëve, brenda dy muajve nga data kur pala që ka caktuar më vonë arbitrin e vet ka njoftuar palën tjetër për këtë takim.

2.2 Kur secila nga Palët Kontraktuese nuk arrin të caktojë arbitrin e vet brenda periudhës së përcaktuar, pala tjetër mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut të realizojë takimin e kërkuar. Një procedurë e njëjtë mund të ndiqet, nëse të dy arbitrat nuk bien dakord për caktimin e arbitrit të tretë.

2.3 Nëse Presidenti i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut është bashkëkombas i një Pale Kontraktuese, detyrat që i atribuohen atij/asaj sipas këtij neni i kalohen Zëvendës-presidentit të Gjykatës ose anëtarit më të lartë të kësaj gjykate, i cili nuk është bashkëkombas i asnjërës prej palëve.

3. Gjykata e arbitrazhit jep verdiktin e vet me shumicë votash. Vendimi i arbitrazhit është i detyrueshëm për të dyja Palët Kontraktuese. Secila Palë Kontraktuese merr përsipër shpenzimet për arbitrin që cakton. Pjesa tjetër e shpenzimeve do të përballohet në mënyrë të barabartë nga të dyja Palët Kontraktuese. Gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë rregullat e saj të procedurës.

PJESA V

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Dispozitat kalimtare

1. Çdo periudhë sigurimi e plotësuar në legjislacionin e secilës palë, përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duhet të merret parasysh për qëllim të përcaktimit të të drejtave të dala nga kjo Marrëveshje.

2. Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të japë të drejta për ndonjë periudhë përpara hyrjes në fuqi.

3. Sipas dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, çdo përfitim, përveç pagesës së menjëhershme, në lidhje me raste të datuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet i pagueshëm, që nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 29

Hyrja në fuqi dhe shtrirja e kësaj Marrëveshjeje

1. Secila palë do të informojë palën tjetër, rreth veprimeve që ka marrë në lidhje me legjislacionin e saj me qëllim sjelljen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas muajit në të cilin janë shkëmbyer instrumentet e ratifikimit.

2. Kjo Marrëveshje do të denoncohet nga njoftimi i bërë prej secilës palë. Denoncimi do të jetë i vlefshëm në fund të gjashtë muajve nga data e njoftimit.

3. Nëse Marrëveshja priset, çdo e drejtë për përfitim e fituar nga një person në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të ruhet dhe bisedimet do të zhvillohen për caktimin e çdo të drejte, përveç atyre të fituara nga këto dispozita. Në rastin kur palët nuk arrijnë në Marrëveshje, mosmarrëveshjet do të zgjidhen në pajtim me nenin 27.

Kjo Marrëveshje është bërë në Tiranë, më 15 korrik 1998, në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe, turke dhe angleze. Në rast paqartësish në interpretim do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ass. Prof. Dr. ANASTAS ANGJELI

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
TURQISË
Prof. Dr. NAMI ÇAGAN

MINISTËR I PUNËS DHE ÇËSHTJEVE
SOCIALE

MINISTËR I PUNËS DHE I SIGURIMIT
SHOQËROR

L I G J
Nr.9067, datë 15.5.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË BELGJIKËS PËR TRANSPORTIN AJROR”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Belgjikës për transportin ajror”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3839, datë 17.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Alfred Moisiu

MARRRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË MBRETËRISË TË BELGJIKËS DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË MBI TRANSPORTIN AJROR

Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë:
duke qënë palë në Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar e hapur për nënshkrim në
Çikago, më 7 dhjetor, 1944;
duke dashur të konkludojnë në Marrëveshje suplementare të Konventës në fjalë për qëllim të
vendosjes së shërbimeve ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre respektive;
duke dashur të sigurojnë shkallën më të lartë të sigurisë dhe të sigurimit në transportin ajror
ndërkombëtar,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje pavarësisht nga konteksti kur e kërkon ndryshe:

a) Termi “Konventë” nënkupton Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar të hapur për nënshkrim në Çikago në ditën e shtatë të dhjetorit 1944 dhe përfshin çdo aneks të përshtatur sipas nenit 90 të kësaj Konvente dhe çdo amendament të anekseve ose të Konventës sipas nenit 90 dhe 94, për aq kohë sa këto anekse dhe amendamente kanë hyrë në fuqi ose janë ratifikuar nga të dyja Palët Kontraktuese.

b) Termi “Marrëveshje” nënkupton këtë Marrëveshje, aneksi i bashkëngjitur aty dhe çdo modifikim të Marrëveshjes ose të aneksit.

c) Termi “autoriteti aeronautik” nënkupton: në rastin e Belgjikës, Ministrinë e Komunikacionit dhe Infrastrukturës dhe në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit, në personin e Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil ose, në të dyja rastet, çdo autoritet tjetër ose person të autorizuar për të përmbushur funksionet e ushtruara tani nga autoritetet e njëjta.

d) Termi “territor”, “shërbim ajror”, “shërbim ajror ndërkombëtar”, “shoqëri ajrore” dhe “ndalesë për qëllime jo të trafikut” kanë kuptimet që janë përcaktuar respektivisht për to në nenin 2 dhe 96 të Konventës.

e) Termi “shoqëri ajrore e përcaktuar” nënkupton një shoqëri ajrore, e cila është përcaktuar dhe autorizuar në përputhje me nenin 3 dhe 4 të kësaj Marrëveshjeje.

f) Termi “shërbime të pranuar” nënkupton shërbimet e rregullta në rrugë të specifikuar në aneksin e kësaj Marrëveshjeje për transportimin e pasagjerëve, mallrave dhe postës, në mënyrë të veçantë ose të kombinuar.

g) Termi “tarifë” nënkupton çmimet që duhet të paguhen për mbartjen e pasagjerëve, bagazheve dhe mallrave dhe kushtet nën të cilat këto çmime aplikohen, duke përfshirë çmimet dhe kushtet për agjenci dhe shërbime të tjera të njëjta, por duke përjashtuar pagesat dhe kushtet për mbartjen e postës.

h) Termi “ndryshim i masave” nënkupton operimin e një prej shërbimeve të pranuar nga një shoqëri ajrore e përcaktuar në një mënyrë të tillë që një seksion rruge të përdoret për fluturim nga avionë të ndryshëm në kapacitet nga ato të përdorura në një seksion tjetër.

i) Termi “pajisjet e avionit”, “pajisjet e tokës”, “pajisjet e magazinuar të avionit”, “pjesë këmbimi” kanë kuptimet që janë përcaktuar respektivisht për to në aneksin 9 të Konventës.

Neni 2

Garantimi i të drejtave

1. Çdo Palë Kontraktuese i garanton Palës tjetër Kontraktuese të drejtat e mëposhtme për qëllim të shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga shoqëritë ajrore të përcaktuara respektive:

a) të fluturojë pa ulje përreth territorit të tij;
b) të bëjë ndalesa në territorin e tij për qëllime jo të trafikut;
c) të bëjë ndalesa në territorin e tij për qëllime të marrjes dhe të shkarkimit, ndërsa janë duke operuar rrugët e specifikuar në aneks, trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve, mallrat dhe postën që kanë origjinën në ose të destinuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Asgjë në paragrafin 1 të këtij neni nuk duhet të gjykohet si konfirmim i shoqërisë ajrore të përcaktuar të një Pale Kontraktuese i privilegjit të marrjes, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, mbartjen e pasagjerëve, të mallrave dhe të postës për shpërbllim ose qira dhe të destinuar për pikën tjetër në territorin e asaj Pale tjetër Kontraktuese.

Neni 3

Përcaktimi i operimeve të shërbimeve

1. Çdo Palë Kontraktuese do të ketë të drejtën t'i përcaktojë me notë diplomatike, Palës tjetër Kontraktuese, një ose më shumë shoqëri ajrore për të operuar shërbimet e pranuar në rrugë të specifikuar në aneks për një Palë Kontraktuese të tillë.

2. Çdo Palë Kontraktuese do të ketë të drejtën të tërheqë, nëpërmjet notave diplomatike të Palës tjetër Kontraktuese, përcaktimin e çdo shoqërie ajrore dhe për të përcaktuar një tjetër.

Neni 4

Autorizimi për të operuar shërbimet

1. Me marrjen e një njoftimi të përcaktuar nga një Palë Kontraktuese në përputhje me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, konsistent me ligjet dhe rregulloret e tij, do t'u japin pa vonesë shoqërive ajrore të përcaktuara autorizimin përkatës për të operuar shërbimet e pranuar për të cilat ato shoqëri ajrore kanë qenë përcaktuar.

2. Me marrjen e autorizimeve të tilla shoqëritë ajrore mund të fillojnë të operojnë në çdo kohë shërbimet e pranuar, tërësisht ose pjesërisht, ka siguruar se shoqëritë ajrore ankohen me dispozitat e aplikuara të kësaj Marrëveshjeje dhe ato tarifa janë vendosur në përputhje me dispozitat e nenit 13 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Revokimi ose pezullimi i autorizimit të operimit

1. Autoritetet aeronautike të secilës Palë Kontraktuese do të kenë të drejtën të mbajnë autorizimet e referuara në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje në respekt të shoqërive ajrore të përcaktuara nga Pala tjetër Kontraktuese, për të revokuar ose pezulluar një autorizim të tillë ose të imponojë kushtet, të përkohshme ose të përhershme:

a) në rastin kur një shoqëri e tillë ajrore nuk i kënaq ato, se ata janë kualifikuar për të përmbushur kushtet e përshkruara sipas ligjeve dhe rregulloreve të aplikuara në mënyrë normale dhe të arsyeshme për operimin e shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga këto autoritete në përputhje me Konventën;

b) në rastin kur shoqëri të tilla ajrore nuk operojnë në përputhje me kushtet e përshkruara sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) në rastin kur shoqëri të tilla ajrore nuk veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e asaj Pale Kontraktuese;

d) në rast se ato nuk janë kënaqur se shoqëritë ajrore janë të futura në dhe kanë vendet e tyre kryesore të biznesit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, dhe më pas mban një certifikatë aktuale të operimit ajror (COP) të lëshuar nga autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Në qoftë se një veprim i mëtejshëm është esencial për të parandaluar shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve të referuara sa më sipër, të drejtat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni do të ushtrohen vetëm pas konsultimeve me autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Aplikimi i ligjeve dhe rregulloreve

1. Ligjet dhe rregulloret e një Pale Kontraktuese në lidhje me qëndrimin ose nisjen nga territori i saj i avionit të përfshirë në navigimin ajror ndërkombëtar ose për operimin dhe navigimin e një avioni të tillë do të kryhet nga shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palës tjetër Kontraktuese nga kjo pikëpamje, nisur nga dhe brenda territorit në fjalë.

2. Ligjet dhe rregulloret e një Pale Kontraktuese, në lidhje me hyrjen, lejet, transitin, imigrimin, pasaportat, doganat, taksat dhe tarifatat, kërkesat sanitare dhe karantinë do të kryhen nga shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palës tjetër Kontraktuese për ose në favor të ekuipazhit të tyre, pasagjerëve, mallrave dhe postës gjatë transitit, pranimit, nisjes nga dhe brenda territorit të një Pale Kontraktuese të tillë.

Pasagjerët në transit nëpërmjet territorit të Palës Kontraktuese do të jenë subjekt të jo më shumë se një kontrolli të thjeshtë.

Ky parashikim nuk do të aplikohet, në qoftë se pasagjeri është në transit në një destinacion të vendosur në një Shtet Palë në Konventën në përputhje me Marrëveshjen Shengen të 14 qershorit 1985.

3. Asnjë prej Palëve Kontraktuese nuk do të ketë preferenca për linjat ajrore të saja ose të ndonjë shoqërie tjetër ajrore ndaj ndonjë shoqërie ajrore, përfshirë në shërbimet ajrore ndërkombëtare të njëjta të Palës tjetër Kontraktuese në aplikimin e rregullave të tij të specifikuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni apo në përdorimin e aeroporteve, linjave ajrore, shërbimeve të trafikut ajror dhe faciliteteve shoqëruese që janë nën kontrollin e tij.

Neni 7

Certifikatat, licencat dhe siguria

1. Certifikatat e vlefshmërisë ajrore, certifikatat e kompetencës dhe licencat e lëshuara ose të bëra të vlefshme nga një Palë Kontraktuese dhe që janë akoma në fuqi, do të njihen si të vlefshme nga Pala tjetër Kontraktuese për qëllim të operimit të shërbimeve të pranuar në rrugët e specifikuara në aneks, ka siguruar se certifikatat e tilla ose licencat janë lëshuar ose bërë të vlefshme në përputhje dhe në konformitet me standardet e vendosura në Konventë.

Çdo Palë Kontraktuese rezervon të drejtën, megjithatë, të refuzojë njohjen, për qëllim të fluturimit mbi territorin e tij, certifikatat e kompetencës dhe licencat e dhëna shtetasve të tij nga Pala tjetër Kontraktuese.

2. Në qoftë se certifikatat ose licencat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë lëshuar ose bërë të vlefshme sipas kërkesave të ndryshme nga standardet e vendosura në Konventë dhe në qoftë se ndryshime të tilla janë bërë me Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese mund të kërkojnë konsultime, në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje, me qëllim që të kënaqin veten e tyre se kërkesat në fjalë janë të pranueshme për ato.

Nëse nuk arrihet një marrëveshje e kënaqshme për çështjet, që kanë të bëjnë me sigurinë e fluturimit, do të ketë vend për aplikimin e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

3.1 Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime në çdo kohë, që kanë të bëjnë me standardet e sigurisë në çdo fushë, që lidhet me ekuipazhin ajror, avionin ose operimin e tyre të adaptuara nga Pala tjetër Kontraktuese. Të tilla konsultime do të kryhen brenda 30 ditëve të kësaj kërkesë.

3.2 Në qoftë se, duke ndjekur të tilla konsultime, një Palë Kontraktuese gjen se Pala tjetër Kontraktuese nuk i mban dhe administron me efektivitet standardet e sigurisë në çdo fushë të tillë, që të paktën janë të barabarta me minimumin e standardeve të vendosura në atë kohë në përputhje me Konventën e Çikagos, Pala e parë Kontraktuese do të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese për ato rezultate dhe hapat e konsideruara të nevojshme për të qenë konform me ato standarde minimume, dhe kjo Palë tjetër Kontraktuese do të ndërmarrë veprime korrekte të përshtatshme.

Nëse Pala tjetër Kontraktuese nuk merr masat përkatëse brenda 15 ditëve ose të një periudhe të tillë të gjatë siç është rënë dakord, do të ketë vend për aplikimin e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje (revokim, pezullim dhe ndryshim të autoriteteve operuese).

3.3 Pavarësisht nga detyrimet e përmendura në nenin 33 të Konventës së Çikagos është pranuar se çdo avion, që operon me një marrëveshje me qira me këste në favor të një shoqërie ajrore ose shoqërive ajrore të një pale në shërbim tek ose nga territori i Palës tjetër Kontraktuese mund, që brenda territorit të Palës tjetër Kontraktuese, të bëhet subjekt i një ekzaminimi nga përfaqësuesit e autorizuar të Palës Kontraktuese, në bord dhe në avion për të kontrolluar të dyja vlefshmërinë e dokumenteve të avionit dhe ato të ekuipazhit të tij dhe kushtet e dukshme të avionit dhe pajisjet e tij (në këtë nen, të quajtur “inspektim i vendqëndrimit të avionëve”), duke kryer këto veprime nuk do të shkaktohen këto vonesa të paarsyeshme.

3.4 Në qoftë se një inspektim i tillë i vendqëndrimit të avionëve ose një seri inspektimesh të vendqëndrimit të avionëve në lidhje me:

a) probleme serioze që një avion ose operimi i një avioni nuk përputhet me standardet minimum të vendosura në atë kohë në përputhje me Konventën e Çikagos;

b) probleme serioze në lidhje me mungesën e një mirëmbajtjeje efektive dhe administrimin e standardeve të sigurisë të vendosura në atë kohë në përputhje me Konventën e Çikagos.

Pala Kontraktuese, që ushtron inspektim për qëllim të nenit 33 të Konventës së Çikagos, do të jetë e lirë të konkludojë kërkesat në të cilat certifikata ose licencat në lidhje me avionin ose në lidhje me ekuipazhin e avionit janë lëshuar ose bërë të vlefshme ose kërkesat në të cilat ai avion operon, nuk janë të barabarta me ose mbi minimumin e standardeve të vendosura në përputhje me Konventën e Çikagos.

3.5 Në raste të pranimit për qëllim të ushtrimit të një inspektimi në vendqëndrimin e avionëve, të një avioni të operuar nga ose në favor të një shoqërie ajrore ose shoqëritë ajrore të një Pale Kontraktuese në përputhje me paragrafin 3.3 të mësipërm mohohet nga përfaqësuesi i asaj shoqërie ose shoqërive ajrore, Pala tjetër Kontraktuese do të jetë e lirë të konkludojë për problemin serioz në lidhje me tipin e referuar në paragrafin 3.4 të mësipërm dhe të dalë me konkluzione referuar në këtë paragraf.

3.6 Çdo Palë Kontraktuese rezervon të drejtën të pezullojë ose të ndryshojë autorizimin e operimit të një shoqërie ajrore ose të shoqërive ajrore të Palës tjetër Kontraktuese menjëherë, në rast se Pala e parë Kontraktuese konkludon, si rezultat i inspektimit në vendqëndrim të avionëve, në një mohim për të kryer një inspektim të vendqëndrimit të avionëve, konsultimet ose përveç kësaj, një veprim i menjëhershëm është esencial për sigurimin e operimit të një shoqërie ajrore.

3.7 Çdo veprim i një Pale Kontraktuese në përputhje me paragrafët 3.2 dhe 3.6 të mësipërm nuk do të vazhdojë nëse nuk ka bazë dhe ky veprim pushon së ekzistuari.

Neni 8

Sigurimi në aviacion

1. Palët Kontraktuese riafirmojnë se detyrimi i tyre për mbrojtje, në lidhjet e tyre të shumanëshme, i sigurisë së aviacionit civil kundër ndërhyrjeve të akteve të paligjshme formojnë një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët Kontraktuese do të sigurojnë me kërkesë të gjithë asistencën e nevojshme për njëra-tjetrën për të parandaluar aktet e paligjshme të rrëmbimit të avionit dhe akte të tjera të paligjshme të sigurisë së pasagjerëve, ekuipazhit, avionit, aeroporteve dhe mjeteve ndihmëse të navigacionit dhe çdo kërcënim tjetër të sigurisë së aviacionit.

3. Palët Kontraktuese do të veprojnë në konformitet me parashikimet e Konventës “Mbi sulmet dhe disa akte të tjera të kryera në bord të avionit”, nënshkruar në Tokio, më 14 shtator 1963, Konventa “Për shtypjen e akteve kundër sigurisë së aviacionit civil”, nënshkruar në Montreal, më 23 shtator 1971 dhe çdo marrëveshje tjetër e shumanëshme, që drejtojnë sigurinë e aviacionit civil, me të cilat lidhen Palët Kontraktuese.

4 Palët Kontraktuese në lidhjet e tyre të shumanëshme, do të veprojnë në përputhje me parashikimet e sigurisë së aviacionit të vendosura nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar dhe të përcaktuara në anekset e Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, duke i shtrirë të tilla dispozita në aplikimin nga palët; ato mund të kërkojnë që operatorët e avionit të regjistrit të tyre ose operatorë, të cilët kanë vendet e tyre të biznesit ose rezidencën e përhershme në territorin e tyre veprojnë në përputhje me dispozitat të tilla të sigurisë së aviacionit.

5. Çdo Palë Kontraktuese bie dakord të vëzhgojë dispozitat e sigurisë të kërkuara nga Pala

tjetër Kontraktuese për të hyrë në territorin e asaj Pale Kontraktuese dhe për të marrë masat e përshtatshme për të inspektuar pasagjerët, ekuipazhin, transportin e materialeve sikurse mallrat para ose gjatë hipjes ose ngarkimit.

6. Çdo Palë Kontraktuese do të japë gjithashtu konsiderata pozitive për çdo kërkesë nga Pala tjetër Kontraktuese për masa speciale të sigurisë për avionin e tij ose për pasagjerët për të përballuar kërcënime të veçanta.

7. Kur ndodh një aksident ose kërcënim i një aksidenti për rrëmbimin e paligjshëm të avionit ose akte të tjera të paligjshme kundër sigurisë së pasagjerëve, ekuipazhit, avionit, aeroporteve dhe mjeteve ndihmëse të navigacionit ajror, Palët Kontraktuese do të ndihmojnë njëra-tjetrën me mjetet ndihmëse të komunikimit dhe masa të tjera të përshtatshme, që kanë për qëllim të përfundojnë shpejt dhe me siguri aksidente të tilla ose të kërcënimeve.

8. Nëse një Palë Kontraktuese nisur nga dispozitat e sigurisë së aviacionit të këtij neni, autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese mund të kërkojnë konsultime të menjëhershme me autoritetet aeronautike të asaj pale. Në rast të mosarritjes së një marrëveshjeje të kënaqshme brenda (30) ditëve do të krijohet vend për aplikimin e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Detyrimet e përdoruesit

1. Detyrimet e imponuara në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese të një shoqërie ajrore, të përcaktuara të Palës tjetër Kontraktuese për përdorimin e aeroporteve dhe të tjera mjete ndihmëse të aviacionit nga avioni i shoqërive ajrore të përcaktuara të Palës tjetër Kontraktuese, nuk duhet të jenë më të larta se ato të imponuara të një shoqërie ajrore kombëtare të Palës së parë Kontraktuese e përfshirë në një shërbim të ngjashëm ndërkombëtar.

2. Çdo Palë Kontraktuese do të inkurajojë konsultime ndërmjet autoriteteve kompetente të detyrimeve dhe shoqërive ajrore të përcaktuara duke përdorur mjetet ndihmëse dhe shërbimet, ku praktikisht, përmes përfaqësuesve të organizmave të shoqërive ajrore duhet të jepet një njoftim i arsyeshëm, për çdo propozim për ndryshime në detyrimet e përdoruesve, që ata të jenë në gjendje të shprehin pikëpamjet e tyre përpara se të jenë bërë ndryshimet.

Neni 10

Përjashtimet nga detyrimet

1. Çdo Palë Kontraktuese do të përjashtojë shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palës tjetër Kontraktuese nga kufizimet e importit, detyrimet doganore, taksat e akcizës, pagesat e inspektimeve dhe të tjera detyrime kombëtare, rajonale dhe lokale dhe detyrime për avionin, karburantin, vajin lubrifikues, pajisjet teknike të konsumit, pjesët e këmbimit duke përfshirë motorët, pajisjet e rregullta të avionit, pajisjet e tokës, rezervat e avionit dhe pajisje të tjera për qëllim përdorimi ose të përdorura vetëm në lidhje me operimin ose shërbimin e avionit të shoqërisë ajrore të përcaktuar të një Pale Kontraktuese, të tillë duke operuar shërbimet e pranuar, stokun e biletave të printuara, faturat e linjave ajrore, çdo material të printuar, që mban simbolin e kompanisë së printuar dhe materiale të zakonshme publicistike të shpërndara pa detyrime nga këto shoqëri ajrore të përcaktuara.

2. Përjashtimet e dhëna nga ky nen do të aplikohen për materialet e referuara paragrafit 1 të këtij neni, pavarësisht nëse të tilla materiale janë ose jo përdorur ose konsumuar tërësisht brenda territorit të Palës Kontraktuese, që bën përjashtimet, duke siguruar tituj të tillë si:

a) të futura në territorin e një Pale Kontraktuese nga ose në favor të shoqërisë ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese, por jo të jenë stabël në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në fjalë;

b) të mbajë në bordin e avionit të shoqërisë ajrore të përcaktuar të një Pale Kontraktuese në mbërritje në ose duke lënë territorin e Palës tjetër Kontraktuese;

c) të marrë në bord të avionit të shoqërisë ajrore të përcaktuar të një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për qëllim të përdorimit në operimin e shërbimeve të pranuar.

3. Pajisjet e rregullta të ngritjes së avionit në ajër, pajisjet e tokës, si dhe materialet dhe furnizimet e mbetura normalisht në bordin e avionit të shoqërisë ajrore të përcaktuar të njëjës Palë Kontraktuese, mund të shkarkohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese vetëm me miratimin e autoriteteve doganore të atij territori. Në një rast të tillë, ato mund të zëvendësohen nën mbikëqyrjen e autoriteteve në fjalë deri në kohën kur ato të rieksporthen ose ndryshe të jenë në dispozicion në përputhje me legjislacionin doganor ose rregulloret.

4. Bagazhet dhe mallrat në transitin direkt do të përjashtohen nga doganat, detyrimet dhe taksat e tjera.

5. Përjashtimet e bëra nga ky nen do të jenë gjithashtu të vlefshme kur shoqëritë ajrore të përcaktuara të njëjës Palë Kontraktuese kanë kontraktuar me një tjetër shoqëri ajrore, e cila gëzon përjashtime të tilla të ngjashme nga Pala tjetër Kontraktuese, për huanë ose transferimin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për titujt e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 11

Kapaciteti

1. Duhet të ekzistojë një mundësi e drejtë dhe e barabartë për shoqëritë ajrore të përcaktuara të secilës Palë Kontraktuese për të operuar shërbimet e pranuara ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre respektive në rrugët e specifikuar në aneksin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Duke operuar shërbimet e pranuar, shoqëritë ajrore të përcaktuara të secilës Palë Kontraktuese do të marrin në llogari interesin e shoqërive ajrore të përcaktuara të Palës tjetër Kontraktuese në atë mënyrë që të mos prekin në mënyrë të pajustificueshme shërbimet, të cilat kjo e fundit i kryen në të gjithë ose në një pjesë të së njëjtës rrugë.

3. Shërbimet e pranuar të kryera nga shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palëve Kontraktuese duhet të kenë marrëdhënie të arsyeshme në lidhje me kërkesat e publikut për transportin në rrugët e specifikuar dhe do të kenë si objektiv kryesor parashikimin e faktorit të arsyeshëm të ngarkesës, të kapacitetit për të plotësuar kërkesat aktuale të arsyeshme për mbajtjen e pasagjerëve, mallrave dhe postës ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese.

4. Shoqëritë ajrore të përcaktuara jo më vonë se 30 ditë para datës së operimit të çdo shërbimi të pranuar, do të pranojnë për miratim programet e propozuara të tyre të fluturimit tek autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese. Programet në fjalë të fluturimit do të përfshijnë p.sh. tipin e shërbimit, përdorimin e avionit, frekuencat dhe skedulat e fluturimit.

Kjo, në mënyrë të njëjtë do të aplikohet në ndryshimet e mëvonshme.

Në raste të veçanta, ky kufi kohor mund të reduktohet si subjekt i pëlqimit të autoriteteve në fjalë.

Neni 12

Ndryshimi i masave dhe ndarja e kodit

1. Shoqëritë ajrore të përcaktuara të njëjës Palë Kontraktuese mund të bëjnë një ndryshim të masave në territorin e Palës tjetër Kontraktuese sipas kushteve të mëposhtme:

a) që zëvendësimi është justifikuar nga operime ekonomike të arsyeshme;

b) avioni, i cili operon në sektorin më të largët nga territori i Palës Kontraktuese, shoqëritë ajrore të përcaktuara do të operojnë vetëm në lidhje me avionin në sektorin më të afërt dhe do të rregullohen të veprojnë në këtë mënyrë; avioni, i cili operon në sektorin më të largët, do të mbërrijë në pikën e ndryshimit për qëllim të mbartjes së trafikut të trashëguar nga ose që transferohet tek avioni në sektorin më të afërt, ndërsa kapaciteti do të përcaktohet me referencat kryesore të këtij qëllimi;

c) shoqëritë ajrore do të mbajnë lidhje me publikun me anë të reklamimeve për të kryer një shërbim, i cili e ka origjinën në pikën ku ndryshimi i avionit është bërë, në qoftë se është lejuar nga aneksi i kësaj Marrëveshjeje;

d) që, në lidhje me çdo avion, që fluturon në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në të cilën është bërë ndryshimi i avionit, vetëm një fluturim mund të bëhet jashtë atij territori, në qoftë se është

autorizuar nga autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese për të operuar më shumë se një fluturim.

2. Pa paragjykuar paragrafin 1 të këtij neni, në operimin e shërbimeve ajrore të pranuar në rrugët e specifikuar në aneks, çdo shoqëri ajrore e përcaktuar, mund të hyjë në rregullime të ndarjes së kodit me një shoqëri ajrore të çdo kombësie, që e lejon shoqërinë ajrore të fundit të mbajë në rrugët përkatëse dhe të drejtat e trafikut.

Neni 13

Tarifat

1. Palët Kontraktuese do të lejojnë që një tarifë në rrugët e specifikuar në aneks do të vendoset nga secila shoqëri ajrore e përcaktuar, në qoftë se është e mundur pas konsultimeve ndërmjet këtyre shoqërive ajrore.

2. Tarifat për mbartjen në shërbimet e pranuar për dhe nga territoret e Palës tjetër Kontraktuese, do të vendosen në nivele të arsyeshme, në lidhje me pagesën e të gjithë faktorëve përkatës, duke përfshirë koston e operimit, përfitimin e arsyeshëm, karakteristikat e shërbimit, interesat e përdoruesit dhe, kur është gjykuar i përshtatshëm, tarifat e shoqërive të tjera ajrore në të gjithë ose pjesë të së njëjtës rrugë.

3. Tarifat do të dorëzohen për miratim nga autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese, të paktën dyzet e pesë (45) ditë përpara datës së propozuar të futjes së tyre; në raste të veçanta një periudhë e shkurtër mund të pranohet nga autoritetet aeronautike.

Në qoftë se brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e marrjes, autoritetet aeronautike të një Pale Kontraktuese nuk kanë njoftuar autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese se ata nuk janë dakord me tarifën e dorëzuar nga ata, të tilla tarifa do të konsiderohen të jenë të pranueshme dhe do të futen në fuqi në datën e vendosur në tarifën e propozuar.

Në rast se është pranuar një periudhë më e shkurtër për dorëzimin e tarifës nga autoritetet aeronautike, ato gjithashtu mund të bien dakord që periudha për dhënien e njoftimit të mosrënies dakord të jetë më pak se tridhjetë (30) ditë.

4. Në qoftë se njoftimi i mosrënies dakord është dhënë në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese do të mbajnë konsultime në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje dhe do të caktojnë tarifën nga marrëveshja ndërmjet tyre.

5. Në qoftë se autoritetet aeronautike nuk janë dakord mbi çdo tarifë të dorëzuar nga ata sipas paragrafit 3 të këtij neni ose me përcaktimet e çdo tarife sipas paragrafit 4 të këtij neni, mosmarrëveshja do të zgjidhet në përputhje me dispozitat e nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje.

6. Në qoftë se autoritetet aeronautike të një Pale Kontraktuese nuk bien dakord me vendosjen e një tarife, ato do të njoftojnë autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese dhe shoqëritë ajrore të përcaktuara do të orvaten kur është kërkuar për të arritur një marrëveshje.

Në qoftë se brenda një periudhe prej nëntëdhjetë (90) ditësh, nga data e marrjes së njoftimit të mosrënies dakord nuk mund të vendoset një tarifë e re, do të aplikohen procedurat siç janë vendosur në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni.

7. Kur tarifën janë vendosur në përputhje me dispozitat e këtij neni, ato tarifa do të mbeten në fuqi derisa të vendosen tarifa të reja në përputhje me nenin 18 të kësaj Marrëveshjeje.

8. Tarifat nuk do të hyjnë në fuqi në qoftë se autoritetet aeronautike të njërit prej Palëve Kontraktuese nuk kanë rënë dakord me përjashtim të dispozitës së paragrafit 4 të nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje.

9. Autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese do të sigurojnë se tarifën e detyrimit dhe të mbledhura konform tarifave të aprovuara nga ata nuk janë subjekt i rimbursimit.

Neni 14

Kërkesat e stafit

1. Shoqëritë ajrore të përcaktuara të një Pale Kontraktuese do të lejohen në baza reciprociteti, të mbajnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese përfaqësuesit e tyre të stafit komercial, operacional dhe teknik, siç është kërkuar në lidhje me operimin e shërbimeve të pranuar.

2. Këto kërkesa stafi sipas mundësive të shoqërive ajrore të përcaktuara, mund të bien dakord

nga vetë personeli i tyre të çdo kombësie ose nga përdorimi i shërbimeve të çdo organizmi tjetër, kompani ose shoqëri ajrore duke operuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe duke autorizuar për të përmbushur shërbime të tilla në territorin e asaj Pale Kontraktuese.

3. Përfaqësuesit dhe stafi do të jenë subjekt i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të Palës tjetër Kontraktuese. Konsistent me ligjet dhe rregulloret e tilla, çdo Palë Kontraktuese, në bazë të reciprocitetit dhe me minimumin e vonësës, do të japë leje për punën e nevojshme, viza punësimi ose dokumente të tjera të ngjashme për përfaqësuesit dhe stafin, referuar paragrafit 1 të këtij neni.

4. Për zgjatjen e lejuar nën ligjin vendas, të dyja Palët Kontraktuese do të sigurojnë me kërkesën për punën e lejuar ose viza punësimi ose dokumente të tjera të ngjashme për personelin, të cilët përmbushin shërbime të sigurta të përkohshme dhe detyra.

Neni 15

Shitjet dhe të ardhurat

1. Çdo shoqëri ajrore e përcaktuar do të japë të drejtën të angazhohet në shitjet e transportit ajror në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në mënyrë direkte dhe me dëshirën e saj, me anë të agjentëve të saj.

Çdo shoqëri ajrore e përcaktuar do të ketë të drejtën të shesë transportim në monedhën e atij territori ose sipas dëshirës së saj, në monedhën e vendeve të tjera.

Çdo person do të jetë i lirë të blejë transportim të tillë në monedha të pranuar për shitje nga ajo shoqëri ajrore.

2. Çdo Palë Kontraktuese u jep shoqërive ajrore të përcaktuara të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën e transfertës së lirë të tepricave të marra nga shpenzimet e fituara nga shoqëria ajrore e përcaktuar në territorin e saj. Të tilla transfertat do të jenë efektive mbi bazën e këmbimit të shkallëve zyrtare për pagesat aktuale ose ku nuk ka këmbime të shkallëve zyrtare, në mbizotërimin e këmbimit të shkallëve zyrtare tregtare të huaja për pagesat aktuale, e aplikueshme në ditën e hyrjes së kërkesës për transfertë nga shoqëria ajrore e përcaktuar nga Pala tjetër Kontraktuese dhe nuk do të jetë subjekt i ndonjë detyrimi me përjashtim të detyrimit të shërbimeve normale të mbledhura nga bankat për transaksione të tilla.

3. Çdo Palë Kontraktuese, në bazë të reciprocitetit, do të përjashtojë shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palës tjetër Kontraktuese nga çdo formë taksimi mbi fitimin ose përfitime të nxjerra nga ato shoqëri ajrore në territorin e Palës së parë Kontraktuese nga operimi i shërbimeve ajrore ndërkombëtare, si dhe për taksat e kthimit ose të kapitalit.

Kjo dispozitë nuk do të aplikohet nëse Konventa për shmangien e një dublimi të taksave për përjashtime të njëjta është në fuqi ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 16

Këmbimi i informacionit

1. Autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese do të këmbëjnë informacion, sa më shumë të jetë e mundur në lidhje me autorizimet aktuale tek shoqëritë e tyre ajrore respektive të përcaktuara, për të kryer shërbimin përmes dhe nga territori i Palës tjetër Kontraktuese. Kjo do të përfshijë kopje të certifikatave dhe të autorizimeve aktuale për shërbimet në rrugët e specifikuar, së bashku me amendamentet, urdhrat e përjashtimit dhe modelet e shërbimeve të autorizuar.

2. Çdo Palë Kontraktuese do të kushtëzojë shoqëritë e saj ajrore të përcaktuara për t'u siguruar autoriteteve aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, praktikisht sa më përpara, kopje të tarifave, kalendarët, duke përfshirë çdo modifikim të bërë dhe të gjitha informacionet e tjera përkatëse, që kanë të bëjnë me operimet e shërbimeve të pranuar, duke përfshirë informacionet rreth kapacitetit të siguruar në secilën nga rrugët e specifikuar dhe çdo informacion tjetër, siç mund të jetë kërkuar për të kënaqur autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, se kërkesat e kësaj Marrëveshjeje janë shqyrtuar plotësisht.

3. Çdo Palë Kontraktuese do të kushtëzojë shoqëritë e saj ajrore të përcaktuara për t'u siguruar autoriteteve aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese statistikë, që kanë lidhje me mbartjen e trafikut në shërbimet e pranuar duke treguar pikat e ngarkimit dhe të shkarkimit.

Neni 17

Konsultime

1. Autoritetet aeronautike të Palës Kontraktuese do të konsultohen me njëra-tjetrën kohë pas kohe, më qëllim për të siguruar kooperim të ngushtë në të gjitha çështjet që ndikojnë në implementimin dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe aneksin e saj.

2. Të tilla konsultime do të fillojnë brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e marrjes së një kërkesë të tillë, nëse nuk është pranuar ndryshe nga Palët Kontraktuese.

Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në qoftë se lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese, fillimisht duhet të orvaten ta zgjidhin atë me bisedime midis tyre.

2. Në qoftë se Palët Kontraktuese nuk arrijnë ta zgjidhin atë me bisedime, ato mund të bien dakord ta referojnë mosmarrëveshjen për vendim tek një person ose bord, ose njëra Palë Kontraktuese mund të paraqesë mosmarrëveshjen për vendim në një gjykatë prej tre arbitrash.

3. Gjykata arbitrale do të përcaktohet si më poshtë:

Çdo Palë Kontraktuese do të emërojë një arbitër brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e marrjes nga një Palë Kontraktuese, nëpërmjet rrugëve diplomatike, të një kërkesë për arbitrim nga Pala tjetër Kontraktuese. Këta dy arbitra do të jenë në marrëveshje për të përcaktuar një arbitër të tretë brenda një periudhe të mëtejshme prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.

Arbitri i tretë do të jetë me një kombësi të një shteti të tretë dhe do të veprojë si një president i gjykatës dhe do të përcaktojë vendin ku do të mbahet arbitrimi.

Në qoftë se njëra Palë Kontraktuese nuk emëron një arbitër brenda periudhës së specifikuar ose në qoftë se arbitri i tretë nuk është përcaktuar brenda periudhës së specifikuar, Presidentit të Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil mund t'i kërkohet nga një Palë Kontraktuese për të përcaktuar një arbitër ose arbitrat sipas rastit të kërkuar.

4. Palët Kontraktuese zotohen që të veprojnë me çdo vendim ose verdikt të dhënë në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

Në qoftë se njëra Palë Kontraktuese nuk arrin të veprojë me një vendim të tillë, Pala tjetër Kontraktuese do të ketë vend për aplikimin e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Shpenzimet e gjykimit arbitrar do të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 19

Modifikimet

1. Në qoftë se njëra Palë Kontraktuese e konsideron atë të nevojshme për të modifikuar çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, mund të kërkojë konsultime me Palën tjetër Kontraktuese. Të tilla konsultime, të cilat mund të bëhen ndërmjet autoriteteve aeronautike dhe të cilat mund të bëhen përmes diskutimeve ose me anë të korrespondencës, do të fillojnë brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e kërkesës.

2. Në qoftë se një konventë e përgjithshme e shumanshme ajrore hyn në fuqi në lidhje me të dyja Palët Kontraktuese, dispozitat e një konvente të tillë do të mbizotërojnë. Konsultimet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni mund të mbahen me pikësynim, që të përcaktojnë shtrirjen në të cilën kjo Marrëveshje është e efektshme nga dispozitat e konventës së shumanshme.

3. Çdo modifikim i pranuar në përputhje me të tilla konsultime do të hyjë në fuqi kur ajo të jetë konfirmuar nga këmbimi i notave diplomatike.

4. Palët Kontraktuese bien dakord se rrugët e rregullta në aneks mund të modifikohen pas marrëveshjes ndërmjet autoriteteve aeronautike përmes një Marrëveshjeje Administrative.

Neni 20
Përfundimi

1. Njëra Palë Kontraktuese mund të japë në çdo kohë njoftim me shkrim përmes rrugëve diplomatike për Palën tjetër Kontraktuese për vendimin e saj për përfundimin e kësaj Marrëveshjeje.

Një njoftim i tillë do t'i komunikohet në mënyrë simulante Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

2. Marrëveshja do të përfundojë një (1) vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese, përderisa njoftimi për të përfunduar është tërhequr nga një konsensus i dyanshëm përpara skadimit të kësaj periudhe.

Në mungesë të marrjes së njohurisë nga Pala tjetër Kontraktuese, njoftimi do të gjykohet që të jetë marrë katërmbëdhjetë (14) ditë pas marrjes së njoftimit nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.

Neni 21
Regjistrimi

Kjo Marrëveshje dhe çdo amendament do të regjistrohet në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Çdo Palë Kontraktuese do të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese përmes rrugëve diplomatike të plotësimit të formaliteteve konstitucionale të kërkuara për të bërë këtë Marrëveshje të efektshme.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit duke ndjekur datën e njoftimit të fundit.

Dëshmohet se të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar nga qeveritë e tyre respektive, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

PROGRAMI I RRUGËVE

1. Rrugët nga Mbretëria e Belgjikës

Pikat e nisjes	Pikat e ndërmjetme	Pikat në Shqipëri	Pikat përtej
Pikat në Belgjikë	Çdonjë	Pikat në Shqipëri	Çdonjë

1. Rrugët në Republikën e Shqipërisë

Pikat e nisjes	Pikat e ndërmjetme	Pikat në Belgjikë	Pikat përtej
Pikat në Shqipëri	Çdonjë	Pikat në Belgjikë	Çdonjë

Çdo pikë ose pikat për rrugët e rëna dakord mund të mospërfshihen nga shoqëritë ajrore të përcaktuara nga të dyja Palët Kontraktuese, ose mund të operohet në mënyra të ndryshme për një ose për të gjitha fluturimet duke parashikuar që pika e nisjes ose mbërritjes ndodhet në vendin e shtetësisë së tyre.

L I G J
Nr.9068, datë 15.5.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS EUROPIANE PËR VLEFSHMËRINË
NDËRKOMBËTARE TË GJYKIMEVE PENALE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale”, me rezervat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 19 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të kërkojë që kërkesat dhe dokumentet mbështetëse të tyre të shoqërohen me përkthimin e tyre në gjuhën shqipe.

Neni 3

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 61 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën për të refuzuar:

- a) ekzekutimin, nëse vlerëson se vendimi ka lidhje me një vepër penale, fiskale ose fetare (Lidhja I, shkronja "a");
- b) ekzekutimin e një dënimi për një akt që, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, është vetëm përgjegjësi e një autoriteti administrativ (Lidhja I, shkronja "b");
- c) ekzekutimin e një gjykimi penal europian, të cilin autoritetet e shtetit kërkesues kanë dhënë në një datë kur, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, procedimi penal i veprës penale të dënuar nga gjykimi duhet të ishte parashkruar (Lidhja I shkronja "c");
- ç) zbatimin e parashikimeve të nenit 8 të Konventës, kur shteti shqiptar ka përgjegjësi origjinale dhe të njohë, në raste të tilla, vetëm njëvlefshmërinë e akteve që ndërpresin ose pezullojnë parashkrimin, të cilat janë kryer në shtetin kërkesues (Lidhja I, shkronja "e").

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3840, datë 17.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTA
EUROPIANE MBI VLEFSHMËRINË NDËRKOMBËTARE TË GJYKIMEVE PENALE
Hagë, më 28.5.1970

HYRJE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente:
duke marrë në konsideratë që lufta kundër kriminalitetit, e cila po kapërcen gjithmonë e më tepër kufijtë administrativë të një shteti të vetëm, kërkon në planin ndërkombëtar përdorimin e mënyrave moderne dhe efikase;
të bindur për nevojën e ndjekjes së një politike penale të përbashkët me qëllim mbrojtjen e shoqërisë;
të ndërgjegjshëm për nevojën e respektimit të dinjitetit njerëzor dhe nxitjen e rehabilitimit të autorëve të veprave penale;
duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi sa më të ngushtë mes anëtarëve të tij,
kanë rënë dakord si vijon:

KAPITULLI I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Në kuptim të kësaj Konvente:

- a) “Vendim penal european” do të thotë çdo vendim përfundimtar i dhënë nga një gjykatë penale e një shteti palë si rezultat i procedimit penal.
- b) “Vepra penale” përshin, përveç veprave të dënueshme nga legjislacioni penal dhe ato të parashikuara në dispozitat ligjore të listuara në lidhjen II të kësaj Konvente, me kusht që në rastin kur këto dispozita i japin kompetencë një autoriteti administrativ, duhet të ekzistojë mundësia për personin e interesuar ta paraqesë çështjen para një gjykate.
- c) “Dënim” do të thotë vendosje e një sanksioni.
- d) “Sanksion” do të thotë çdo lloj dënimi ose masë tjetër e vendosur shprehimisht ndaj një personi për shkak të kryerjes së një veprë penale dhënë nga një gjykim penal european ose një ordonnance penale.
- e) “Humbje” do të thotë çdo humbje ose pezullim i një të drejte ose çdo ndalim ose humbje e zotësisë.
- f) “Gjykim i bërë në mungesë” do të thotë çdo vendim i konsideruar i tillë sipas nenit 21 paragrafi i dytë.
- g) “Ordonnance penale” do të thotë çdo vendim i dhënë në një shtet tjetër palë dhe i listuar në lidhjen II të kësaj Konvente.

KAPITULLI II
EKZEKUTIMI I GJYKIMEVE PENALE EUROPIANE

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

A) Kushte të përgjithshme të ekzekutimit

Neni 2

Kjo pjesë zbatohet ndaj:

- a) sanksioneve që përfshijnë heqjen e lirisë;

- b) gjobave ose konfiskimeve;
- c) heqjes ose kufizimit të një ose disa të drejtave.

Neni 3

1. Një shtet palë do të jetë kompetent në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Konventë për ekzekutimin e sanksioneve të vendosura në një shtet tjetër palë, të cilat janë të ekzekutueshme në këtë të fundit.

2. Kjo kompetencë mund të ushtrohet vetëm pas paraqitjes së një kërkesë nga një shtet tjetër palë.

Neni 4

1. Sanksioni nuk do të ekzekutohet nga një shtet tjetër palë, përveçse kur sipas legjislacionit të tij veprimi, për të cilin është vendosur sanksioni do të përbënte vepër penale, nëse do të ishte kryer në territorin e tij dhe personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni do të ishte i dënueshëm atje.

2. Nëse vendimi trajton dy ose më shumë vepra penale dhe jo të gjitha përmbushin kërkesat e paragrafit të parë, shteti dënues do të specifikojë cilat pjesë të sanksionit zbatohen për veprat penale që përmbushin ato kërkesa.

Neni 5

Shteti dënues mund t'i kërkojë një shtet tjetër palë të ekzekutojë sanksionin vetëm nëse një ose më shumë nga kushtet vijuese janë përmbushur:

- a) nëse personi i dënuar ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në shtetin tjetër;
- b) nëse ekzekutimi i sanksionit në shtetin tjetër duket se do të sjellë shtimin e mundësive për rehabilitimin social të personit të dënuar;
- c) nëse, në rastin e një sanksioni me heqje të lirisë, sanksioni mund të ekzekutohet duke ndjekur ekzekutimin e një sanksioni tjetër me heqje të lirisë që i dënuari vuan ose duhet të vuajë në këtë shtet;
- d) nëse shteti tjetër është shteti i origjinës së personit të dënuar dhe është deklaruar i gatshëm të marrë përsipër ekzekutimin e këtij sanksioni;
- e) nëse konsideron se nuk është në gjendje ta ekzekutojë vetë sanksionin, edhe pse ka bërë kërkesë për ekstradim dhe shteti tjetër ka mundësi.

Neni 6

Ekzekutimi i kërkuar në përputhje me dispozitat e mësipërme nuk mund të refuzohet tërësisht ose pjesërisht, përveç rasteve kur:

- a) ekzekutimi do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik të shtetit të kërkuar;
- b) shteti i kërkuar e konsideron veprën penale për të cilin është dhënë dënimi të karakterit politik ose tërësisht ushtarak;
- c) shteti i kërkuar konsideron se ka arsye serioze për të besuar se dënimi është provokuar ose rënduar për arsye race, besimi fetar, kombësie ose bindjeje politike;
- d) ekzekutimi është në kundërshtim me angazhimet ndërkombëtare të shtetit të kërkuar;
- e) vepra është objekt procedimi në shtetin e kërkuar ose kur ky i fundit vendos të fillojë procedimin lidhur me këtë vepër;
- f) autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar vendosin të mos procedojnë ose të mbyllin procedimin për këtë vepër;
- g) vepra është kryer jashtë territorit të shtetit të kërkuar;
- h) shteti i kërkuar nuk është në gjendje të ekzekutojë sanksionin;
- i) kërkesa bazohet në nenin 5 shkronja "a" dhe asnjë nga kushtet e tjera të parashikuara në atë dispozitë nuk është përmbushur;
- j) shteti i kërkuar konsideron se shteti kërkuar është vetë në gjendje ta ekzekutojë sanksionin;

k) mosha e personit të dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale ishte e tillë që ai nuk mund të procedohej në shtetin e kërkuar;

l) sanksioni është parashikuar tashmë sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar;

m) vendimi përcakton heqjen ose kufizimin e një ose më shumë të drejtave.

Neni 7

Kërkesa për ekzekutim nuk do të zbatohet nëse ekzekutimi bie ndesh me parimet e njohura nga dispozitat e seksionit të parë të kapitullit III të kësaj Konvente.

B) Pasojat e transferimit të ekzekutimit

Neni 8

Në funksion të nenit 6 paragrafi i parë dhe rezervën e përmendur në shkronjën “c” të lidhjes I të kësaj Konvente, çdo vepër që ndërpret ose pezullon parashkrimin e përmbushur vlefshmërisht nga autoritetet e shtetit dënues, do të konsiderohet në shtetin e kërkuar sikur të ketë prodhuar të njëjtin efekt për zbatimin e parashkrimit sipas legjislacionit të këtij shteti.

Neni 9

1. Një person i dënuar, i burgosur në shtetin kërkues, që i është dorëzuar shtetit të kërkuar për qëllim të ekzekutimit, nuk do të procedohet, gjykohet, dënohet për shkak të ekzekutimit të një dënimi ose mase sigurimi dhe as do t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë vetjake për një veprim të ndryshëm nga ai për të cilin është dhënë vendimi për t'u ekzekutuar, përveçse në rastet kur:

a) Shteti që e ka dorëzuar bie dakord. Për këtë gjë atij do t'i paraqitet një kërkesë, e shoqëruar me të gjitha dokumentet e nevojshme dhe një procesverbal gjyqësor që përmban të gjitha deklaratimet e bëra nga i dënuari. Pëlqimi do të jepet kur vepra penale për të cilën ai është kërkuar është gjithashtu subjekt ekstradimi sipas legjislacionit të shtetit kërkues të ekzekutimit ose kur ekstradimi mund të përjashtohet vetëm për arsye të masës së dënimit.

b) Personi i dënuar ka pasur mundësinë e largimit nga territori i shtetit ku është dorëzuar, por nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve nga dorëzimi i tij përfundimtar ose nëse është kthyer në këtë territor, pasi është larguar prej tij.

2. Shteti i kërkuar për të ekzekutuar dënimin mundet sidoqoftë të marrë çdo masë të nevojshme për zhvendosjen e personit nga territori i tij ose çdo masë të nevojshme sipas legjislacionit të tij, përfshirë këtu procedimin në mungesë, me qëllim parandalimin e pasojave ligjore të parashkrimit.

Neni 10

1. Ekzekutimi do të rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar dhe vetëm ky shtet do të jetë kompetent për marrjen e vendimeve të duhura që përfshijnë lirinë me kusht.

2. Vetëm shteti kërkues ka të drejtë të vendosë për çdo kërkesë për rishikim të dënimit.

3. Secili nga të dy shtetet mund të ushtrojë të drejtën e amnistisë ose të faljes.

Neni 11

1. Kur shteti dënues kërkon ekzekutimin, ai nuk mund të fillojë ekzekutimin e një sanksioni subjekt i kësaj kërkesë. Shteti dënues mundet sidoqoftë të fillojë ekzekutimin e një sanksioni me heqje të lirisë, kur personi i dënuar është tashmë i burgosur në territorin e atij shteti në momentin e paraqitjes së kërkesës.

2. Shteti kërkues rifiton të drejtën për ekzekutim kur:

a) Tërheq kërkesën e tij, para se shteti i kërkuar ta ketë informuar atë për ndonjë qëllim të tijin për të ndërmarrë veprime për trajtimin e kërkesës.

b) Shteti i kërkuar e informon për refuzimin e tij për të ndërmarrë veprime për trajtimin e kërkesës.

c) Shteti i kërkuar heq dorë në mënyrë të shprehur nga e drejta e tij për ekzekutim. Heqja dorë mund të jetë e vlefshme vetëm nëse të dy shtetet përkatëse bien dakord për këtë ose nëse ekzekutimi nuk është më i mundur në shtetin e kërkuar. Në rastin e fundit heqja dorë është e detyrueshme, nëse shteti kërkuar ka bërë kërkesë për këtë.

Neni 12

1. Autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar duhet t'i japin fund ekzekutimit menjëherë sapo marrin dijeni për çfarëdo falje, amnisti ose rekurs për rishikim ose çdo vendim tjetër që ka për pasojë pushimin e karakterit ekzekutiv të sanksionit. E njëjta gjë do të zbatohet për ekzekutimet e gjobave sa kohë që personi i dënuar i ka paguar gjobën autoriteteve kompetente të shtetit kërkuar.

2. Shteti kërkuar do të informojë pa vonesë shtetin e kërkuar për çdo vendim ose veprim procedural të ndërmarrë në territorin e tij që ka për pasojë parashkrimin e të drejtës për ekzekutim në përputhje me paragrafin e mësipërm.

C. Dispozita të ndryshme

Neni 13

1. Transitimi nëpërmjet territorit të një shteti palë të një personi të burgosur, i cili duhet të transferohet tek një shtet i tretë palë në zbatim të kësaj Konvente, do të akordohet me kërkesën e shtetit në të cilin personi ndodhet i burgosur. Shteti i transitit mund të kërkojë të marrë çdo dokument të nevojshëm para se të marrë vendim lidhur me kërkesën. Personi që transferohet do të qëndrojë në burg në territorin e shtetit të transitit, përveçse kur shteti nga i cili ai transferohet kërkon lirinë e tij.

2. Përveç rasteve kur transferimi kërkohet në përputhje me nenin 34, çdo shtet palë mund të refuzojë transitin:

a) për një nga motivet e përmendura në nenin 6, shkronja "b" dhe "c";

b) nëse personi në fjalë është shtetas i tij.

3. Nëse përdoret transporti ajror, zbatohen dispozitat vijuese:

a) kur nuk parashikohet ulje e avionit, shteti nga i cili transferohet personi mund të njoftojë shtetin mbi territorin e të cilit do të fluturohet që personi në fjalë po transferohet në zbatim të kësaj Konvente. Në rastin e një uljeje të parashikuar ky njoftim do të ketë vlerën e kërkesës për arrest të përkohshëm sikurse parashikohet në nenin 32 paragrafi i dytë dhe do të bëhet një kërkesë formale për transitin;

b) kur parashikohet ulje e avionit, do të bëhet një kërkesë formale për transitin.

Neni 14

Shtetet palë nuk kërkojnë nga njëri-tjetri shlyerjen e shpenzimeve që kryhen në zbatim të kësaj Konvente.

SEKSIONI 2 KËRKESA PËR EKZEKUTIM

Neni 15

1. Kërkesat e parashikuara në këtë Konventë do të bëhen me shkrim. Ato dhe të gjitha komunikimet e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente do t'i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë së shtetit të kërkuar nga Ministria e Drejtësisë e shtetit kërkuar ose, nëse shtetet palë bien dakord, direkt nga autoritetet e shtetit kërkuar atyre të shtetit të kërkuar; përgjigjet ndjekin të njëjtën rrugë.

2. Në raste urgjente, kërkesat dhe komunikimet mund të dërgohen përmes Organizatës

Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

3. Çdo shtet palë, me anë të një deklarate të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të njoftojë qëllimin e tij për t'iu shmangur rregullave të komunikimit të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 16

Kërkesa për ekzekutim do të shoqërohet nga origjinali ose një kopje e vërtetuar e vendimit, ekzekutimi i të cilit kërkohet dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme. Origjinali ose një kopje e vërtetuar e të gjithë ose e një pjese të dosjes penale i komunikohet shtetit të kërkuar me kërkesë të këtij të fundit. Autoriteti kompetent i shtetit kërkues vërteton ekzekutimin e sanksionit.

Neni 17

Nëse shteti i kërkuar konsideron që informacioni i dhënë nga shteti kërkues nuk është i mjaftueshëm për t'i dhënë mundësinë atij të zbatojë këtë Konventë, ai kërkon informacion shtesë, duke fiksuar një afat për marrjen e këtij informacioni.

Neni 18

1. Autoritetet e shtetit të kërkuar informojnë pa vonesë ato të shtetit kërkues për veprimet e ndërmarra për trajtimin e kërkesës për ekzekutim.

2. Autoritetet e shtetit të kërkuar i transmetojnë atyre të shtetit kërkues, kur është rasti, një dokument që vërteton ekzekutimin e sanksionit.

Neni 19

1. Nën rezervën e paragrafit të dytë të këtij neni, nuk do të kërkohet asnjë përkthim i kërkesave ose i dokumenteve shtesë.

2. Çdo shtet palë mundet të rezervojë, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi ose aderimit, me anë të një deklarate me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të drejtën e tij për të kërkuar që kërkesat dhe dokumentet mbështetëse të shoqërohen me përkthimin e tyre në gjuhën e tij, në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës ose në një nga gjuhët që kërkon ai. Shtetet e tjera palë mund të kërkojnë reciprocitet.

3. Kjo dispozitë nuk cenon dispozitat që lidhen me përcaktimin e kërkesave dhe dokumenteve mbështetëse që mund të parashikohen në marrëveshje të tjera tashmë në fuqi ose që mund të lidhen në të ardhmen midis dy ose më shumë shteteve palë.

Neni 20

Materialet shkresore dhe dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk është e nevojshme të legalizohen.

SEKSIONI 3 GJYKIMET NË MUNGESË DHE ORDONNANCE PENALE

Neni 21

1. Nën rezervën e parashikimeve të ndryshme të bëra në këtë Konventë, ekzekutimi i vendimeve të gjyqësorëve në mungesë dhe i ordonnance penale u nënshtrohen të njëjtave rregulla sikurse ekzekutimi i vendimeve të tjera gjyqësore.

2. Nën rezervën e parashikimeve të paragrafit të tretë, një vendim në mungesë sipas kësaj Konvente nënkupton çdo vendim të dhënë nga një gjykatë e një shteti palë pas procedimit penal, gjatë shqyrtimit të të cilit personi i dënuar nuk ka qenë personalisht i pranishëm.

3. Pa paragjykuar përmbajtjen e neneve 25 paragrafi i dytë, 26 paragrafi i dytë dhe 29, do të

konsiderohet si vendim i marrë në prani të të akuzuarit:

a) çdo vendim i dhënë në mungesë dhe çdo ordonnance penale, që është konfirmuar ose dhënë në shtetin dënues pas kundërshtimit nga personi i dënuar;

b) çdo vendim i marrë në mungesë në apel, nëse apelimi për vendimin e gjykatës së shkallës së parë është kërkuar nga personi i dënuar.

Neni 22

Çdo vendim në mungesë dhe çdo ordonnance penale, që nuk është kundërshtuar ose apeluar mund t'i transmetohet menjëherë shtetit të kërkuar me qëllim njoftimin dhe ekzekutimin e mundshëm të tyre.

Neni 23

1. Nëse shteti i kërkuar e konsideron të përshtatshme të ndërmarrë veprime mbi kërkesën për ekzekutimin e një vendimi në mungesë ose të një ordonnance penale, ai do t'ia njoftojë të dënuarit personalisht vendimin e marrë në shtetin kërkuar.

2. Në aktin e njoftimit dërguar të dënuarit do të jepet edhe informacioni se:

a) në përputhje me këtë Konventë është paraqitur një kërkesë për ekzekutim;

b) e vetmja rrugë ankimi e vlefshme është kundërshtimi i parashikuar në nenin 24;

c) kundërshtimi bëhet pranë autoritetit të përcaktuar, pranimi i kundërshtimit është objekt i kushteve të parashikuara në nenin 24 të kësaj Konvente, dhe se personi i dënuar mund të kërkojë të dëgjohet nga autoritetet e shtetit dënues;

d) nëse nuk bëhet asnjë kundërshtim brenda afatit të përshkruar, vendimi do të konsiderohet i marrë në prani të të akuzuarit në përputhje me këtë Konventë.

3. Një kopje e njoftimit do t'i dërgohet menjëherë autoritetit që ka kërkuar ekzekutimin.

Neni 24

1. Pasi vendimi është njoftuar në përputhje me nenin 23, rruga e vetme e ankimit për të dënuarit është kundërshtimi. Ky kundërshtim do të shqyrtohet sipas zgjedhjes së të dënuarit ose nga gjykata kompetente në shtetin kërkuar, ose nga ajo e shtetit të kërkuar. Nëse personi i dënuar nuk shpreh asnjë zgjedhje, kundërshtimi do të shqyrtohet nga gjykata kompetente në shtetin e kërkuar.

2. Në rastet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, kundërshtimi do të pranohet nëse ai i është drejtuar autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda afatit 30 ditor duke filluar nga data në të cilën është bërë njoftimi. Ky afat do të llogaritet në përputhje me rregullat përkatëse të legjislacionit të shtetit të kërkuar. Autoriteti kompetent i këtij shteti do të njoftojë menjëherë autoritetin që ka bërë kërkesën për ekzekutim.

Neni 25

1. Nëse kundërshtimi shqyrtohet në shtetin kërkuar, personi i dënuar duhet të paraqitet në këtë shtet në seancën e fiksuar për shqyrtimin e ri të çështjes. Paraqitja do t'i njoftohet atij personalisht të paktën 21 ditë para seancës. Kjo periudhë mund të shkurtohet me pëlqimin e të dënuarit. Shqyrtimi i ri do të mbahet para gjykatës që është kompetente në shtetin kërkuar dhe sipas procedurës së këtij shteti.

2. Nëse personi i dënuar nuk paraqitet personalisht ose nuk përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit kërkuar, gjykata e deklaron kundërshtimin të pakryer dhe vendimi i saj i komunikohet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar. E njëjta procedurë do të ndiqet dhe nëse gjykata e deklaron kundërshtimin të papranueshëm. Në të dyja rastet vendimi në mungesë ose masa penale do të konsiderohet, në përputhje me këtë Konventë, sikur të jetë marrë në praninë e të akuzuarit.

3. Nëse personi i dënuar paraqitet personalisht ose përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit kërkuar dhe nëse kundërshtimi deklarohet i pranueshëm, kërkesa për ekzekutim do të

konsiderohet sikur të mos jetë bërë.

Neni 26

1. Nëse kundërshtimi shqyrtohet në shtetin e kërkuar, personi i dënuar duhet të paraqitet në atë shtet në seancën e fiksuar për shqyrtimin e ri të çështjes. Njoftimi për paraqitje do t'i bëhet atij personalisht jo më vonë se 21 ditë para seancës së re. Kjo periudhë mund të shkurtohet me pëlqimin e personit të dënuar. Shqyrtimi i ri do të mbahet para gjykatës që është kompetente në shtetin e kërkuar dhe sipas procedurës së këtij shteti.

2. Nëse personi i dënuar nuk paraqitet personalisht ose nuk përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit të kërkuar, gjykata e deklaron kundërshtimin të pakryer dhe vendimi i saj i komunikohet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar. E njëjta procedurë do të ndiqet dhe nëse gjykata e deklaron kundërshtimin të papranueshëm. Në të dyja rastet vendimi në mungesë ose masa penale do të konsiderohet, në përputhje me këtë konventë, sikur të jetë marrë në praninë e të akuzuarit.

3. Nëse personi i dënuar paraqitet personalisht ose përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit kërkuar dhe nëse kundërshtimi deklarohet i pranueshëm, çështja do të gjykohet sikur të jetë kryer në këtë shtet. Sidoqoftë, çështja nuk mund të shqyrtohet nëse procedimi penal është parashkuar. Vendimi i marrë në shtetin kërkuar do të konsiderohet sikur të mos jetë marrë.

4. Të gjitha veprimet lidhur me procedimet ose hetimet paraprake të ndërmarra në shtetin dënues, në përputhje me legjislacionin e tij që është në fuqi kanë të njëjtën vlerë në shtetin e kërkuar, sikur të jenë ndërmarrë nga autoritetet e atij shteti, por ky asimilim nuk i jep atyre fuqi provuese më të madhe, sesa ato kanë në shtetin kërkuar.

Neni 27

Për ngritjen e kundërshtimit dhe procedurës që e shoqëron, i dënuari në mungesë ose për një masë penale ka të drejtë t'i vendoset kryesisht një mbrojtës në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji i shtetit të kërkuar dhe, kur është e nevojshme, të shtetit kërkuar.

Neni 28

Çdo vendim gjyqësor i dhënë në përputhje me nenin 26 paragrafi i tretë, si dhe ekzekutimi i tij rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar.

Neni 29

Nëse një person i dënuar në mungesë ose për një masë penale nuk ngre kundërshtim, vendimi do të konsiderohet, në përputhje me këtë Konventë, sikur të jetë marrë në prani të të akuzuarit.

Neni 30

Legjislacionet kombëtare janë të zbatueshme në fushën e rikthimit tërësor, nëse personi i dënuar, për arsye të pavarura nga vullneti i tij, nuk respekton afatet e përcaktuara në nenet 24, 25 dhe 26 ose nuk paraqitet personalisht në seancën e fiksuar për shqyrtimin e ri të çështjes.

SEKSIONI 4 MASA TË PËRKOHSHME

Neni 31

Nëse personi i dënuar është i pranishëm në shtetin kërkuar pas marrjes së njoftimit të pranimit të kërkesës së tij për ekzekutimin e një vendimi me heqje të lirisë, ky shtet mundet, nëse e sheh të nevojshme për të siguruar ekzekutimin, ta arrestojë atë me qëllim transferimin e tij sipas

parashikimeve të nenit 43.

Neni 32

1. Kur shteti kërkues ka kërkuar ekzekutimin, shteti i kërkuar mund ta arrestojë personin e dënuar kur:

- a) ligji i shtetit të kërkuar autorizon paraburgimin për këtë veprë penale;
- b) ekziston rreziku i largimit ose, në rastin e një dënimi në mungesë, rreziku i dëmtimit të provave.

2. Kur shteti kërkues njofton qëllimin e tij për të kërkuar ekzekutimin, shteti i kërkuar mundet, në zbatim të kërkesës së shtetit kërkues, ta arrestojë personin e dënuar, me kusht që të plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin e mësipërm, shkronjat (a) dhe (b). Kërkesa duhet të përmendë veprën penale që solli dënimin, kohën dhe vendin e kryerjes së saj, si edhe përshkrimin sa më të saktë të personit të dënuar. Ajo duhet të përmbajë gjithashtu një përshkrim të shkurtër të akteve në të cilat bazohet dënimi.

Neni 33

1. Personi i dënuar do të mbahet në burg në përputhje me legjislacionin e shtetit të kërkuar; ky legjislacion përcakton gjithashtu kushtet në të cilat ai mund të lirohet.

2. Personi i burgosur do të lirohet në të gjitha ato raste kur:

- a) kohëzgjatja e burgimit arrin atë të sanksionit të dhënë me heqje lirie;
- b) ai është arrestuar në zbatim të nenit 32 paragrafi i dytë dhe shteti i kërkuar nuk arriti të merrte brenda 18 ditëve nga data e arrestimit, kërkesën së bashku me dokumentet e specifikuara në nenin 16.

Neni 34

1. Një person i mbajtur në burg në shtetin e kërkuar, në përputhje me nenin 32, dhe që duhet të paraqitet para gjykatës kompetente të shtetit kërkues në përputhje me nenin 25, si pasojë e kundërshtimit që ai ka ngritur, do të transferohet për këtë qëllim në territorin e shtetit kërkues.

2. Pas transferimit, ky person nuk do të mbahet në burg nga shteti kërkues, nëse janë kushtet e përcaktuara në nenin 33 paragrafi i dytë ose nëse shteti kërkues nuk kërkon ekzekutimin e dënimit të ri. Personi do të kthehet menjëherë në shtetin e kërkuar, përsa kohë që ai nuk është liruar.

Neni 35

1. Një person i thirrur në një gjykatë kompetente të shtetit kërkues si rezultat i kundërshtimit që ai ka ngritur nuk do të procedohet, gjykohet dhe as do të dënohet, përsa i përket ekzekutimit të një dënimi ose mase sigurie dhe as do t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë vetjake për një arsye çfarëdo që ka lindur para largimit të tij nga territori i shtetit të kërkuar dhe nuk është specifikuar në ftesën për paraqitje, përveçse kur ky person jep pëlqimin shprehimisht me shkrim. Në rastin e parashikuar në paragrafin e parë të nenit 34, një kopje e deklaratës së pëlqimit do t'i transmetohet shtetit prej nga është transferuar personi.

2. Pasojat e parashikuara në paragrafin e mësipërm pushojnë kur personi i ftuar, pasi ka pasur mundësinë që të veprojë, nuk është larguar nga territori e shtetit kërkues brenda 15 ditëve pas datës së dhënies së vendimit që pason seancën në të cilën ai është paraqitur ose, nëse ai është kthyer në atë territor, pasi është larguar prej tij, pa qenë i detyruar për t'u paraqitur sërish.

Neni 36

1. Nëse shteti kërkues ka kërkuar ekzekutimin e një konfiskimi pasurie, shteti i kërkuar mund të procedojë me marrjen e përkohshme të pasurisë në fjalë, me kusht që legjislacioni i tij e parashikon marrjen për raste të ngjashme.

2. Marrja e pasurisë rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar, i cili do të përcaktojë

kushtet në të cilat mund të hiqet masa e marrjes së pasurisë.

SEKSIONI 5 EKZEKUTIMI I SANKSIONEVE

A. Përcaktime të përgjithshme

Neni 37

Një sanksion i vendosur në shtetin kërkues nuk do të ekzekutohet në shtetin e kërkuar, përveçse me anë të një vendimi të një gjykate në shtetin e kërkuar. Çdo shtet palë mundet sidoqoftë të ngarkojë autoritete të tjera të marrin vendime të tilla, nëse sanksioni që do të ekzekutohet është vetëm një gjobë ose konfiskim dhe nëse këto vendime janë të apelueshme në një gjykatë.

Neni 38

Çështja shqyrtohet nga gjykata ose nga autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37, nëse shteti i kërkuar vëren se ka vend për të ndërmarrë veprime lidhur me kërkesën për ekzekutim.

Neni 39

1. Para se të marrë një vendim mbi kërkesën, gjykata i jep mundësinë personit të dënuar të shfaqë mendimin e tij, kur ky i fundit e kërkon këtë, përmes paraqitjes së tij personalisht përpara gjykatës ose përmes paraqitjes së një letre rogatore. Dëgjimi personalisht ndodh pas kërkesës së shprehur posaçërisht të vetë personit të dënuar.

2. Gjkata mundet sidoqoftë të vendosë për pranimin e kërkesës për ekzekutim në mungesë të personit që kërkon të paraqitet para gjykatës, nëse ai është i burgosur në shtetin kërkues. Në këto rrethana çdo vendim për zëvendësimin e sanksionit sipas nenit 44 do të shtyhet për sa kohë që personit të dënuar, pas transferimit të tij në shtetin e kërkuar, i është dhënë mundësia për t'u paraqitur para gjykatës.

Neni 40

1. Gjkata ose, në rastet e parashikuara në nenin 37, autoriteti i ngarkuar sipas të njëjtës dispozitë, sigurohet që:

- a) sanksioni, ekzekutimi i të cilit kërkohet është vendosur në një gjykim penal europian;
- b) kërkesat e nenit 4 janë përmbushur;
- c) kushti i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 6 nuk është përmbushur ose nuk bie ndesh me ekzekutimin;
- d) ekzekutimi nuk bie ndesh me nenin 7;
- e) në rastin e një dënimi në mungesë ose të një ordonnance penale, kërkesat e seksionit 3 të këtij kapitulli janë përmbushur.

2. Secili shtet palë mund ta ngarkojë gjykatën ose autoritetin e përcaktuar sipas nenit 37 me verifikimin e kushteve të tjera të ekzekutimit të parashikuara në këtë Konventë.

Neni 41

Vendimet gjyqësore të marra në përputhje me këtë seksion sipas kërkesave për ekzekutim dhe ato të marra mbi apelimet ndaj vendimeve të autoriteteve administrative sipas nenit 37, duhet të jenë të apelueshme.

Neni 42

Konstatimet e fakteve janë për shtetin e kërkuar të detyrueshme për sa kohë që ato janë paraqitur në vendim ose për sa kohë ky vendim bazohet heshtazi në to.

B) Dispozita të veçanta për ekzekutimin e sanksioneve me heqje lirie.

Neni 43

Kur personi i dënuar është burgosur në shtetin kërkues, me përjashtim të rastit kur legjislacioni i atij shteti parashikon ndryshe, ai duhet të transferohet në shtetin e kërkuar menjëherë pasi shteti kërkues të jetë njoftuar për pranimin e kërkesës për ekzekutim.

Neni 44

1. Nëse kërkesa për ekzekutim pranohet, gjykata duhet të zëvendësojë sanksionin me heqje lirie të vendosur në shtetin kërkues me një sanksion të parashikuar nga legjislacioni i tij për të njëjtën vepër penale. Ky sanksion mundet, në kufijtë e treguar në paragrafin e dytë, të jetë i një natyre ose kohëzgjatjeje tjetër nga ai i vendosur në shtetin kërkues. Nëse ky sanksion i fundit është më i vogël në minimum, sesa ai që mund të vendoset sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar, gjykata nuk është e detyruar të respektojë këtë minimum dhe zbaton një sanksion që i korrespondon sanksionit të vendosur në shtetin kërkues.

2. Në vendosjen e sanksionit, gjykata nuk duhet të rëndojë pozitën penale të personit të dënuar që rezulton nga vendimi i dhënë në shtetin kërkues.

3. Çdo pjesë e sanksionit të vendosur në shtetin kërkues dhe e gjithë periudha e burgimit paraprak të vuajtur nga personi i dënuar pas dënimit do të llogaritet e plotë. E njëjta gjë do të zbatohet përsa i përket burgimit paraprak të vuajtur nga personi i dënuar në shtetin kërkues para dënimit të tij, për aq sa legjislacioni i atij shteti e rregullon këtë llogaritje.

4. Çdo shtet palë mundet në çdo kohë të depozitojë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës një deklaratë, e cila i jep atij të drejtën, në përputhje me këtë Konventë, të ekzekutojë një sanksion me heqje lirie të të njëjtës natyre me atë të vendosur në shtetin kërkues, edhe pse kohëzgjatja e këtij sanksioni kapërcen maksimumin e parashikuar nga legjislacioni i tij kombëtar për një sanksion të së njëjtës natyre. Sidoqoftë, ky rregull do të zbatohet vetëm për rastet kur legjislacioni kombëtar i këtij shteti e lejon, për të njëjtën vepër penale, vendosjen e një sanksioni që ka të paktën të njëjtën kohëzgjatje sa ai i vendosur në shtetin kërkues, por që është i një natyre më të rëndë. Sanksioni i vendosur sipas këtij paragrafi mund të ekzekutohet, nëse kohëzgjatja dhe qëllimi i tij e kërkojnë kështu, në një institucion penal të caktuar për ekzekutimin e sanksioneve të një natyre tjetër.

C. Dispozita të veçanta për ekzekutimin e gjobave dhe konfiskimeve

Neni 45

1. Nëse kërkesa për ekzekutimin e një gjobe ose konfiskimi të një shume parash pranohet, gjykata ose, autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 konverton shumën në monedhën e shtetit të kërkuar sipas kursit të shkëmbimit në fuqi në momentin e marrjes së vendimit. Ajo përcakton edhe masën e gjobës ose shumën që duhet të konfiskohet, e cila nuk duhet të tejkalojë maksimumin e shumës së fiksuar në legjislacionin e saj për të njëjtën vepër penale ose, në mungesë të maksimumit ligjor, maksimumin e shumës së dhënë zakonisht në shtetin e kërkuar për një vepër të tillë penale.

2. Sidoqoftë, gjykata ose autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 mund t'i përmbahet për shumën e vendosur në shtetin kërkues, dënimit me gjobë ose konfiskimit, kur një sanksion i tillë nuk parashikohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale, por ky legjislacion lejon vendosjen e sanksioneve më të rënda. I njëjti rregullim zbatohet edhe nëse sanksioni i vendosur në shtetin kërkues tejkalon maksimumin e parashikuar në legjislacionin e shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale, por ky legjislacion lejon vendosjen e sanksioneve më të rënda.

3. Të gjitha lehtësirat e pagimit të dhëna në shtetin kërkues, si përsa i përket afatit, edhe pagimit me këste, do të respektohen në shtetin e kërkuar.

Neni 46

1. Kur kërkesa për ekzekutim përmban konfiskimin e një objekti të veçantë, gjykata ose autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 mund të urdhërojë konfiskimin e atij objekti vetëm nëse ky konfiskim autorizohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale.

2. Sidoqoftë, gjykata ose autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 mund t'i përmbahen konfiskimit të urdhëruar në shtetin kërkuar, kur ky sanksion nuk parashikohet në legjislacionin e shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale, por ky legjislacion lejon vendosjen e sanksioneve më të rënda.

Neni 47

1. Gjambat e paguara dhe konfiskimet hyjnë në thesarin e shtetit të kërkuar, pa paragjykuar të drejtat e personave të tretë.

2. Objektet e konfiskuara që paraqesin një interes të veçantë, mund t'i kthehen shtetit kërkuar me kërkesën e tij.

Neni 48

Nëse ekzekutimi i një gjobe bëhet i pamundur, mund të zbatohet nga një gjykatë e shtetit të kërkuar një sanksion zëvendësues me heqje lirie, nëse legjislacioni i të dy shteteve e parashikon një rast të tillë, përveçse kur shteti kërkuar e kufizon kërkesën e tij shprehimisht në ekzekutimin vetëm të gjobës. Nëse gjykata vendos një sanksion zëvendësues me heqje lirie, zbatohen rregullat vijuese:

a) Nëse konvertimi i një gjobe në një sanksion me heqje lirie është parashikuar tashmë në vendimin e dhënë në shtetin kërkuar ose direkt në ligjin e atij shteti, gjykata e shtetit të kërkuar përcakton natyrën dhe kohëzgjatjen e këtij sanksioni në përputhje me rregullat e vendosura në legjislacionin e saj. Nëse sanksioni me heqje lirie të parashikuar tashmë në shtetin kërkuar është më i vogël sesa minimumi, i cili mund të vendoset sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar, gjykata nuk është e detyruar të respektojë këtë minimum dhe vendos një sanksion tjetër korrespondues të sanksionit të parashikuar në shtetin kërkuar. Kur gjykata vendos një sanksion, ajo nuk mund të rëndojë pozitën penale të personit të dënuar që rezulton nga vendimi i marrë në shtetin kërkuar.

b) Në rastet e tjera, gjykata e shtetit të kërkuar procedon me konvertimin e gjobës sipas legjislacionit të saj, duke respektuar kufijtë e parashikuar nga legjislacioni i shtetit kërkuar.

D. Dispozita të veçanta për ekzekutimin e heqjes ose kufizimit të një ose më shumë të drejtave

Neni 49

1. Kur paraqitet një kërkesë për ekzekutimin e heqjes ose kufizimit të një të drejte të vendosur në shtetin kërkuar, ajo sjell pasoja vetëm nëse legjislacioni i shtetit të kërkuar lejon vendosjen e heqjes së saj për një vepër të tillë penale.

2. Gjkata që shqyrton çështjen vlerëson dobinë e ekzekutimit të heqjes të së drejtës në territorin e shtetit të saj.

Neni 50

1. Nëse gjykata urdhëron ekzekutimin e heqjes të së drejtës, ajo duhet të përcaktojë kohëzgjatjen brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni i saj, pa kapërcyer ato të vendosura nga vendimi dhënë në shtetin kërkuar.

2. Gjkata mund të kufizojë heqjen e së drejtës vetëm për një pjesë të të drejtave për të cilat është vendosur heqja ose pezullimi.

Neni 51

Neni 11 nuk zbatohet për heqjen ose kufizimin e të drejtave.

Neni 52

Shteti i kërkuar ka të drejtë t'i rikthejë personit të dënuar të drejtat nga të cilat ai është privuar, në përputhje me vendimin e marrë në zbatim të këtij seksioni.

KAPITULLI III PASOJAT NDËRKOMBËTARE TË GJYKIMEVE PENALE EUROPIANE

SEKSIONI 1 NE BIS IN IDEM

Neni 53

1. Një person, ndaj të cilit është zhvilluar një gjykim penal europian, nuk mund të procedohet, gjykohet apo të bëhet objekt ekzekutimi i një sanksioni në një shtet tjetër palë për të njëjtin fakt kur:

- a) ai është shpallur i pafajshëm;
- b) sanksioni i vendosur:
 - i) është ekzekutuar plotësisht ose është duke u ekzekutuar;
 - ii) është objekt i një faljeje ose amnistie në tërësinë e tij ose për pjesën e paekzekutuar;
 - iii) nuk mund të ekzekutohet më, pasi është parashkruar;
- c) gjykata konstaton fajësinë e autorit, por nuk vendos ndonjë sanksion.

2. Sidoqoftë, një shtet palë nuk është i detyruar, përveçse, kur ai vetë ka kërkuar procedimin, të njohë pasojat e “ne bis in idem”, nëse veprimi që i dha shkas gjykimit është drejtuar kundër ndonjë personi, institucioni ose sendi që ka karakter publik në këtë shtet ose nëse personi objekt i gjykimit kishte një karakter publik në këtë shtet.

3. Gjithashtu, çdo shtet palë në të cilin është kryer veprimi ose është konsideruar i tillë në përputhje me legjislacionin e atij shteti, nuk është i detyruar të njohë pasojat e “ne bis in idem” përveçse, kur ky shtet ka kërkuar procedimin.

Neni 54

Nëse fillohen procedime të reja kundër një personi të gjykuar për të njëjtin fakt në një shtet tjetër palë, çdo periudhë heqje lirie e vuajtur për ekzekutimin e një vendimi do të llogaritet në sanksionin që mund të vendoset.

Neni 55

Ky seksion nuk pengon zbatimin e rregullave kombëtare më të gjera lidhur me pasojat e “ne bis in idem” për gjykimet penale të huaja.

SEKSIONI 2 MARRJA NË KONSIDERATË

Neni 56

Çdo shtet palë merr masat legjislative, që i vlerëson të përshtatshme për t'u dhënë mundësi gjykatave, kur ato japin vendime, për të marrë në konsideratë të gjitha vendimet e mëparshme penale europiane të dhëna për një vepër tjetër penale pas paraqitjes së të akuzuarit, me qëllim që t'i bashkëlidhë atij vendimi të gjitha pasojat ose një pjesë të tyre, të cilat legjislacioni i tij ia bashkëlidh vendimeve të dhëna në territorin e tij. Ai përcakton kushtet në të cilat është dhënë ky vendim.

Neni 57

Çdo shtet palë merr masat legjislative që i vlerëson të përshtatshme për të dhënë mundësinë e marrjes në konsideratë të të gjitha vendimeve penale europiane të dhëna pas paraqitjes së të akuzuarit, me qëllim bërjen të zbatueshme të të gjitha ose të një pjese të heqjeve të zotësive të bashkëlidhura sipas legjislacionit të tij vendimeve të dhëna në territorin e tij. Ai përcakton kushtet në të cilat është

dhënë ky vendim.

KAPITULI IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 58

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të përfaqësuara në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës. Ajo mund të ratifikohet ose pranohet. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimi do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose të pranimi.

3. Për shtetet nënshkruese që e ratifikojnë ose e pranojnë këtë Konventë më vonë, ajo do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit ose të pranimi.

Neni 59

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderojë në këtë Konventë. Rezoluta që përmban këtë ftesë duhet të marrë miratimin unanimit të anëtarëve të Këshillit që kanë ratifikuar këtë Konventë.

2. Aderimi do të kryhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti aderimi, i cili do të ketë efekt tre muaj pas datës së depozitimit.

Neni 60

1. Çdo shtet palë në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimi ose të aderimit, mund të specifikojë territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet palë, gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimi ose të aderimit, ose në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në cilindo territor ose territore të specifikuar në deklaratë, territore për të cilat ai është përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare ose për të cilat ai është i autorizuar të lidhë marrëveshje.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm mund të tërhiqet përsa i përket territoreve të përmendura në atë deklaratë, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 66 të kësaj Konvente.

Neni 61

1. Çdo shtet palë, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimi ose të aderimit, mund të deklarojë përdorimin prej tij të një ose më shumë rezervave të parashikuara në lidhjen I të kësaj Konvente.

2. Çdo shtet palë mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë të formuluar nga ai në përputhje me paragrafin e mësipërm, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila sjell pasoja që nga data e marrjes së saj.

3. Shteti palë që ka bërë një rezervë për një parashikim të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë zbatimin e atij parashikimi nga një shtet tjetër; sidoqoftë ai mund të pretendojë, nëse rezerva është e pjesshme ose e kushtëzuar, zbatimin e kësaj dispozite në masën që ai vetë e ka pranuar.

Neni 62

1. Çdo shtet palë mundet në çdo kohë të tregojë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, dispozitat ligjore për t'u përfshirë në lidhjen II dhe III të kësaj Konvente.

2. Çdo ndryshim i dispozitave kombëtare të përmendura në lidhjen II ose III duhet t'i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, nëse ky ndryshim e bën të pasaktë informacionin e dhënë në ato lidhje.

3. Çdo ndryshim i bërë në lidhjen II ose III në zbatim të paragrafit të mësipërm sjell pasoja për çdo shtet palë një muaj pas datës së njoftimit të tyre nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 63

1. Çdo shtet palë duhet t'i japë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në momentin e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me sanksionet e zbatueshme në atë shtet dhe ekzekutimin e tyre lidhur me zbatimin e kësaj Konvente.

2. Çdo ndryshim i mëvonshëm që e bën të pasaktë informacionin e dhënë sipas paragrafit të mësipërm duhet t'i njoftohet në të njëjtën mënyrë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 64

1. Kjo Konventë nuk cenon as të drejtat dhe as detyrimet që rrjedhin prej marrëveshjeve të ekstradimit dhe konventave ndërkombëtare shumëpalëshe që përmbajnë fusha specifike, as dispozitat që përmbajnë fushat që janë objekt i kësaj Konvente të përcaktuara në konventa të tjera ekzistuese ndërmjet shteteve palë.

2. Shtetet palë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe mes tyre, lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë vetëm për të plotësuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen aty.

3. Sidoqoftë, nëse dy ose më shumë shtete palë kanë vendosur ose janë duke vendosur marrëdhënie ndërmjet tyre mbi bazën e një legjislacioni uniform ose të një regjimi të veçantë, ata do të kenë të drejtë të rregullojnë marrëdhëniet e tyre të ndërsjella të kësaj fushe duke u bazuar ekskluzivisht në këto sisteme, pavarësisht nga dispozitat e kësaj Konvente.

4. Shtetet palë që pushojnë së zbatuari dispozitat e kësaj Konvente lidhur me marrëdhëniet e tyre të ndërsjella në këtë fushë, duhet të njoftojnë për këtë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 65

Komiteti European për çështjet penale i Këshillit të Europës do të ndjekë zbatimin e kësaj Konvente dhe do të bëjë gjithçka të nevojshme për arritjen e zgjidhjeve miqësore të vështirësive që mund të lindin gjatë zbatimit të saj.

Neni 66

1. Kjo Konventë do të mbetet në fuqi për një afat kohor të pacaktuar.

2. Çdo shtet palë, përsa i përket asaj, mund ta denoncojë këtë Konventë nëpërmjet një njoftimi të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 67

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të përfaqësuara në Komitetin e Ministrave të Këshillit dhe çdo shtet tjetër, i cili ka aderuar në këtë Konventë për:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimit ose aderimi;

- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 58 të saj;
- d) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 19 paragrafit të dytë;
- e) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 44 paragrafit të katërt;
- f) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 60;
- g) çdo rezervë të bërë në përputhje me dispozitat e nenit 61 paragrafi i parë dhe tërheqjen e një rezerve të tillë;
- h) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 62 paragrafit të parë dhe çdo njoftim të mëtejshëm të marrë në përputhje me atë dispozitë, paragrafi i dytë;
- i) çdo njoftim të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 63 paragrafi i parë dhe çdo njoftim të mëtejshëm të marrë në përputhje me atë dispozitë, paragrafi i dytë;
- j) çdo njoftim përsa i përket marrëveshjeve të dyanshme ose të shumanshme të lidhura në përputhje me nenin 64 paragrafi i dytë ose përsa i përket legjislacionit uniform të futur sipas nenit 64 paragrafi i tretë;
- k) çdo njoftim të marrë në përputhje me nenin 66 dhe datën në të cilën bëhet i efektshëm denoncimi.

Neni 68

Kjo Konventë, deklaratat dhe njoftimet e autorizuar prej saj zbatohen vetëm për ekzekutimet e vendimeve të dhëna pas hyrjes në fuqi të Konventës ndërmjet shteteve palë të interesuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 28 maj 1970, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëllor të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet nënshkrues dhe aderues.

Lidhja I

Çdo shtet palë mund të deklarojë se rezervon të drejtën:

- a) të refuzojë ekzekutimin, nëse konsideron se dënimi përbën një shkelje fiskale ose fetare;
- b) të refuzojë ekzekutimin e një sanksioni për një veprim, i cili sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar i përkiste kompetencës ekskluzive të një autoriteti administrativ;
- c) të refuzojë ekzekutimin e një gjykimi penal evropian, të cilin autoritetet e shtetit kërkuar kryen në një datë kur, sipas legjislacionit të tij, procedimi penal i veprës penale të dënuar nga gjykimi duhet të ishte parashkruar;
- d) të refuzojë ekzekutimin e sanksioneve të vendosura në mungesë dhe masave penale, ose vetëm të njërit nga kategoritë e vendimeve;
- e) të refuzojë zbatimin e parashikimeve të nenit 8, kur ky shtet ka një kompetencë origjinale dhe të njohë në raste të tilla vetëm ekuivalencën e akteve që ndërpresin ose pezullojnë parashkrimin, akte që janë kryer në shtetin kërkuar;
- f) të pranojë zbatimin e pjesës III përsa i përket njërit nga dy seksionet e saj.

Lidhja II

Lista e shkeljeve të tjera, përveç atyre të klasifikuara si vepra penale nga legjislacioni penal.

Shkeljet (veprat) e mëposhtme konsiderohen si vepra penale:

- Në Francë: Çdo sjellje e paligjshme e sanksionuar si e tillë nga një "contravention de grande voirie".
- Në RFGJ: Çdo sjellje e paligjshme e sanksionuar si e tillë përmes procedurave të përcaktuara nga Akti mbi Thyerjen e Rregullave (gesetz über ordnungswidrigkeiten) i 24 majit 1968 (BGBl 1968, I 481).
- Në Itali: Çdo sjellje e paligjshme e sanksionuar si e tillë përmes Aktit nr.317 të 3 marsit 1967.

Lidhja III

Austri – Nenet 460-462 të Kodit të Procedurës Penale.
Danimarkë - Neni 931 i Aktit mbi Administrimin e Drejtësisë.
Francë - 1. Nenet 524-528 të Kodit të Procedurës Penale shtuar me nenet R42-R50; 2. Ordonnance Penale të zbatueshme vetëm në departamentet e Bas-Rhin, Haut-Rhin dhe Moselle.
Gjermani – 1. Nenet 407-412 dhe 413 të Kodit të Procedurës Penale; 2. Nenet 65-66 të Aktit të 24 majit 1968 (BGBl 1968 I, 481).
Itali – 1. Nenet 506-510 të Kodit të Procedurës Penale. 2. Akti i 7 janarit 1929, nr.4 për çështjet fiskale. 3. Nenet 1242-1243 të Kodit të Llundrit. 4. Vendimi në zbatim të Aktit nr.317 të 3 marsit 1967.
Luksemburg – 1. Akti i 31 korrikut 1924 për organizimin e ordonnances penaleso. 2. Neni 16 i aktit të 14 shkurtit 1955 për trafikun në autostradat publike.
Norvegji – 1. Nenet 287-290 të Aktit për Procedurat gjyqësore në çështjet penale. 2. Neni 31B i Kodit Rrugor të 18 qershorit 1965.
Suedi – Kapitulli 48 i Kodit të Procedurave.
Turqi – Nenet 386 –391 të Kodit të Procedurës Penale dhe të gjitha vendimet sipas të cilave autoritetet administrative vendosin sanksione.

L I G J
Nr.9069, datë 15.5.2003

**PËR POLICINË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 13 pika 1, 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Policia Ushtarake është strukturë e specializuar në përbërje të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ajo është në varësi të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ka për mision:

- a) ruajtjen e rendit ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
- b) zbulimin, parandalimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale në Forcat e Armatosura;
- c) angazhimin në luftën kundër terrorizmit;
- ç) marrjen pjesë në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare;
- d) mbrojtjen e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura nga veprimtari të kundërligjshme.

Neni 2

Veprimtaria e Policisë Ushtarake mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në dispozitat e këtij ligji dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Në përmbushje të misionit dhe të realizimit të detyrave, Policia Ushtarake bashkëvepron me komandat e reparteve dhe të njësive të Forcave të Armatosura, me drejtuesit e institucioneve ushtarake, me strukturat informative ushtarake, Policinë e Shtetit, Shërbimin Informativ Shtetëror, policitë e tjera, të njohura me ligj, dhe me organet e pushtetit vendor.

Neni 4

Policia Ushtarake, në kuadrin e bashkëpunimit, shkëmben informacione me strukturat e tjera shtetërore, duke ruajtur sekretin dhe dinjitetin e ushtarakëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Personeli i Policisë Ushtarake, përveç të drejtave të përcaktuara në këtë ligj, gëzon dhe të gjitha të drejtat e ushtarakut të Forcave të Armatosura, të njohura me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

KREU II ORGANIZIMI I POLICISË USHTARAKE

Neni 6

Struktura e Policisë Ushtarake është e organizuar në bazë njësie e nënrepartesh, sipas planit të përhapjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Në strukturën e Policisë Ushtarake, si organ i specializuar për zbulimin, parandalimin, ndjekjen e veprimtarisë kriminale dhe kapjen e personave që kanë kryer, kryejnë ose përgatiten të kryejnë krime ushtarake në Forcat e Armatosura, organizohet struktura e Policisë Kriminale Ushtarake.

Struktura e Policisë Kriminale Ushtarake, për sigurimin e informacionit të nevojshëm, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ngarkuar me ligj, shfrytëzon burimet njerëzore, mjetet teknike dhe elektronike të hapura dhe të mbyllura. Ajo, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes, ngre rrjet të fshehtë informativ, përdor mbikëqyrjen e fshehtë, krijon dhe përdor evidencën operative, përdor mjetet teknike dhe elektronike, bën përgjime telefonike e kontroll postar, duke marrë më parë miratimin tek autoriteti i përcaktuar me ligj.

Neni 8

Për organizimin, sigurimin dhe kontrollin e trafikut ushtarak organizohet dega e qarkullimit rrugor, e cila e ushtron veprimtarinë në mbështetje të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë".

Neni 9

Policia Ushtarake, me atributet e Policisë Gjyqësore, kryen hetime të plota për vepra penale që ndodhin në Forcat e Armatosura. Në strukturën e Policisë Ushtarake organizohen seksionet dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me ligjin nr.8677, datë 2.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

Neni 10

Për kontrollin e masave të marra nga komandat e forcave në Forcat e Armatosura dhe nga

drejtuesit e institucioneve ushtarake për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe të pronës ushtarake nga rreziku i zjarrit dhe i fatkeqësive të tjera, në strukturën e Policisë Ushtarake organizohet inspektorati i PMNZSH-së, i cili e kryen veprimtarinë në përputhje me ligjin nr.8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin".

Neni 11

Personeli i Policisë Ushtarake pajiset me dokument identifikimi, të cilin e paraqet gjatë kryerjes së detyrës.

Personeli i Policisë Ushtarake ka shenjat dalluese dhe simbolet, të përcaktuara në Rregulloren e Forcave të Armatosura për uniformën.

Pajisjet profesionale janë të njëjta me ato që ka në përdorim Policia e Shtetit.

KREU III DETYRAT E POLICISË USHTARAKE

Neni 12

Policia Ushtarake, në përmbushje të misionit, kryen këto detyra:

- a) siguron rendin ushtarak jashtë reparteve ushtarake, në mjediset publike dhe jopublike;
- b) mbron jetën, shëndetin dhe dinjitetin e ushtarakut nga çdo veprim i paligjshëm, kur ato cenohen për shkak të detyrës;
- c) mbron pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura nga veprimtari të kundërligjshme;
- ç) me kërkesë të komandave dhe të drejtuesve të institucioneve ushtarake, ndërhyjnë në repartet ushtarake për parandalimin dhe mënjanimin e veprimeve të kundërligjshme që kanë të bëjnë me prishjen e rendit ushtarak;
- d) ndërhyjnë për të mënjeluar aktet e terrorizmit në Forcat e Armatosura;
- dh) punon për zbulimin, parandalimin e ndjekjen e veprimtarisë kriminale ndaj pjesëtarëve të Forcave të Armatosura, pronës e objekteve ushtarake;
- e) zbaton vendimet e gjykatës, aktet e Prokurorisë Ushtarake për kërkimin, kapjen e sjelljen forcërisht të ushtarakëve, që i fshihen procedimit penal ose i shmangen vuajtjes së dënimit;
- ë) kërkon e ndalon ushtarakët, që i shmangen shërbimit të detyrueshëm ushtarak;
- f) kontrollon e siguron transportin ushtarak;
- g) kontrollon lëvizjen dhe shfrytëzimin e mjeteve dhe të teknikës luftarake;
- gj) kontrollon e merr masa për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen nga zjarri;
- h) siguron rendin ushtarak gjatë zhvillimit të stërvitjeve, të veprimtarive dhe ceremonive ushtarake, të organizuara në Forcat e Armatosura;
- i) Policia Ushtarake, në gjendje lufte, bën sigurimin e personelit, të materialeve dhe mjeteve luftarake nga sulmet e armikut në prapavijë;
merr masa për grumbullimin, evakuimin, ruajtjen dhe sigurimin e robërve të luftës, si dhe të personelit civil të ndaluar ;
mban nën kontroll rrjetin rrugor në zonat e operacioneve dhe kontrollon lëvizjet e refugjatëve;
- j) shoqëron e siguron personalitetet e larta ushtarake të Forcave të Armatosura, si dhe delegacionet e huaja ushtarake të njësuara me to;
- k) kryen detyra në interes të forcave ushtarake shqiptare, që kryejnë misione jashtë shtetit, si dhe të forcave të huaja ushtarake, që veprojnë në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- l) kryen operacione humanitare;
- ll) Realizon, me urdhër të autoritetit epror të Policisë Ushtarake, lirim të objekteve e të territoreve ushtarake të zëna forcërisht;

Neni 13

Bashkëpunimi ndërmjet Policisë Ushtarake dhe strukturave ose organeve të tjera, të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, rregullohet me udhëzime të përbashkëta të titullarëve të

institucioneve përkatëse.

Neni 14

Për strukturat e shërbimeve të Policisë Ushtarake, që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në bazë të ligjeve të veçanta, Ministri i Mbrojtjes nxjerr urdhra dhe udhëzime.

KREU IV TË DREJTAT E POLICISË USHTARAKE

Neni 15

Personeli i Policisë Ushtarake ka të drejtë të hyjë në mjediset e reparteve e të institucioneve ushtarake vetëm:

- a) kur ka të dhëna të bazuara se është duke u kryer një krim;
- b) për kapjen e autorëve të një krimi, të cilët janë fshehur në këto mjedise;
- c) për të dhënë ndihmën e nevojshme në raste aksidentesh, zjarresh e fatkeqësish natyrore.

Personeli i Policisë Ushtarake ka të drejtë të futet në objektet e mbyllura dhe në zyrat e komandave ushtarake vetëm me kërkesë të këtyre të fundit ose me urdhër të prokurorit ushtarak.

Neni 16

Punonjësve të shërbimeve të Policisë Ushtarake (Policia Kriminale, Gjyqësore, e Qarkullimit Rrugor), që kryejnë detyra në interes të njësive e reparteve të Forcave të Armatosura, u krijohen kushte dhe mjedise pune të përshtatshme për kryerjen e detyrës së tyre funksionale brenda njësive e reparteve, nga komandat e forcave dhe drejtuesit e institucioneve ushtarake.

Neni 17

Në raste urgjente, për kryerjen e detyrave të shërbimit, personeli i Policisë Ushtarake përdor mjetet e transportit e të ndërlidhjes të Forcave të Armatosura, si dhe të personave fizikë e juridikë shqiptarë.

Në rastet e përdorimit të tyre, personeli i Policisë Ushtarake detyrohet t'i lëshojë personit fizik e juridik një vërtetim, në bazë të të cilit struktura ku shërben ky punonjës policie i kthen në të holla vlerën e shpenzimeve të kryera.

Ministri i Mbrojtjes nxjerr udhëzim për zbatimin e përcaktimeve të bëra në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni.

Neni 18

Punonjësit e Policisë Ushtarake bllokojnë pjesë të rrugëve, zyra e mjedise të tjera, ku ka ndodhur vepra penale, për ruajtjen e vendit të ngjarjes dhe të provave materiale deri në ardhjen e Policisë Gjyqësore ose të prokurorit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 19

Policia Ushtarake bën kontrolle, bllokon prova materiale e ndalon ushtarakët dhe shtetas të tjerë në rastet e kushteve të flagrancës së kryerjes të një veprë penale ushtarake, në përputhje me dispozitat e caktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 20

Punonjësi i Policisë Ushtarake kërkon prej ushtarakut të paraqesë dokumentin zyrtar të identifikimit në rastet kur:

- ai ndodhet në vendngjarjen e veprës penale;
- ka të dhëna për veprimtari të paligjshme të ushtarakut;

vepron në kundërshtim me rregulloret ushtarake;
ç) bëhen verifikime.

Neni 21

Punonjësi i Policisë Ushtarake shoqëron për në qendrën e repartit të Policisë Ushtarake ose të institucionit ushtarak, ushtarakët që:

a) shkelin rregullat e rendit ushtarak dhe nuk ndërpresin veprimtarinë e tyre edhe pas paralajmërimit;

b) nuk kanë dokument identifikimi ose refuzojnë ta paraqesin;

c) kundërshtojnë ose pengojnë punonjësin e Policisë Ushtarake në kryerjen e detyrës;

ç) janë gjendur në vendngjarje dhe dyshohet se janë autorë të veprës penale;

d) kërkojnë nga organet e drejtësisë.

Kur një person i paraqitur si ushtarak rezulton se nuk është i tillë, ai shoqërohet në qendrën më të afërt të Policisë Ushtarake.

Neni 22

Ushtarakëve, që shoqërohen në repartet e Policisë Ushtarake, u krijohen kushte normale dhe, pas sqarimit të rrethanave të çështjes për të cilën janë shoqëruar, kur nuk janë të implikuar, lihen të lirë. Ata nuk mund të mbahen më shumë se 10 orë.

Për veprimet e kryera, punonjësi i Policisë Ushtarake njofton menjëherë eprorët e vet të drejtpërdrejtë, repartin, familjen e ushtarakut, si dhe plotëson dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 23

Punonjësit e Policisë Ushtarake përdorin forcën, mjetet dhe pajisjet e tjera speciale, të dhëna në përdorim, në bazë dhe për zbatim të ligjit, kur kundërshtohen e pengohen gjatë kryerjes së detyrës edhe:

a) ndaj ushtarakëve ose shtetasve që përpiqen të lirojnë personat e shoqëruar nga punonjësi i Policisë Ushtarake;

b) kur të ndaluarit ose personat që shoqërohen bëjnë përpjekje të largohen forcërisht;

c) për të vendosur rendin ushtarak, të cenuar rëndë nga veprime të pakontrolluara të ushtarakëve ose të një grupi ushtarakësh.

Neni 24

Gjatë kryerjes së detyrës, punonjësi i Policisë Ushtarake përdor armën si mjet ekstrem, vetëm në bazë të dispozitave të ligjit nr.8290, datë 24.2.1998 "Për përdorimin e armëve të zjarrit".

KREU V

PRANIMI, KUALIFIKIMI DHE SHËRBIMI NË POLICINË USHTARAKE

Neni 25

Policia Ushtarake përbëhet nga efektivë oficerë, nënoficerë e ushtarë me pagesë.

Neni 26

Në Policinë Ushtarake pranohen nënoficerë dhe ushtarë me pagesë, shtetasit shqiptarë mbi baza vullnetare, që plotësojnë këto kërkesa:

a) të kenë mbaruar arsimin e mesëm;

b) të kenë kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak;

c) të mos jenë dënuar penalisht me burgim, me vendim gjykate të formës së prerë;

ç) të plotësojnë kushtet shëndetësore e fizike;

d) të jenë në moshë deri 30 vjeç dhe me gjatësi trupore mbi 1.70 m;
dh) të kenë sjellje të mira qytetare.

Përfshihen nga plotësimi i kërkesave të përcaktuara në shkronjën "b" të këtij neni, shtetasit shqiptarë femra.

Neni 27

Kriteret e emërimit, të kualifikimit dhe të karrierës së oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve me pagesë të Policisë Ushtarake janë ato të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr.8670, datë 26.10.2000 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe në aktet nënligjore, të miratuara për këtë qëllim.

Neni 28

Kur punonjësi i Policisë Ushtarake vritet ose bëhet i paaftë për punë, gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të detyrës, familja e tij ose ai vetë përfitojnë pension në masën e pagës së plotë që ka pasur në çastin që i lind e drejta për këtë përfitim.

Kur punonjësit e Policisë Ushtarake, gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, i dëmtohet prona, ai ka të drejtën e kompensimit, masa dhe kriteret e së cilës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 29

Gjatë përmbushjes së detyrave të caktuara me ligj, efektivat e Policisë Ushtarake zbatojnë dispozitat e ligjit nr.8291, datë 25.2.1998 "Kodi i etikës së Policisë".

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 28, dhe Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të neneve 7, 14 dhe 17 të këtij ligji të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse.

Neni 31

Ligji nr.7508, datë 7.8.1991 "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 32

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3841, datë 17.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

V E N D I M
Nr.216, datë 10.4.2003

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË
TEKNOLOGJIVE TË INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e dokumentit të strategjisë kombëtare të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.19, datë 12.6.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci Anëtar i“““
Gjergj Sauli Anëtar i“““
Alfred Karamuço Anëtar i“““
Kristofor Peçi Anëtar i“““
Kujtim Puto Anëtar i“““
Petril Plloçi Anëtar i“““
Sokol Sadushi Anëtar i“““
Xhezair Zaganjori Anëtar i“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 8.5.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.24 Akti që i përket:

KËRKUES: GJERGJ BARDHAJ, përfaqësuar nga avokati Dino Leli, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.5, datë 1.2.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.21, datë 7.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f e 134/g të Kushtetutës dhe ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

Për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme, kërkuesi Gjergj Bardhaj ka parashtruar përpara Gjykatës Kushtetuese këto shkaqe:

- Në gjykimin e bërë në Gjykatën e Apelit Shkodër nuk ka marrë pjesë asnjë avokat, qoftë edhe i caktuar kryesisht, duke shkelur kështu të drejtat e garantuara nga neni 31/ç i Kushtetutës.

- Gjykimi në shkallën e parë është bërë me avokat të caktuar kryesisht, i cili pa dijeninë e të akuzuarit ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit kundër vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

- Shkeljet e mësipërme janë parashtruar edhe në rekurs, por në Dhomën e Këshillimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, padrejtësisht ka vendosur mospranimin e rekursit, në vend që ta dërgonte këtë çështje në seancë gjyqësore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e kërkuarit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.76, datë 11.11.1999, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka dënuar Gjergj Bardhaj me 18 vjet burg për veprat penale të vrasjes me paramendim dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara në nenet 78 dhe 278/2 të Kodit Penal. Gjykimi është bërë në mungesë të të pandehurit, por me mbrojtës të caktuar kryesisht, i cili brenda afatit ligjor ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit kundër vendimit të sipërcituar, duke kërkuar ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale nga vrasje me paramendim (neni 78 i Kodit Penal) në vrasje me dashje (neni 76 i Kodit Penal). Me vendimin nr.5, datë 1.2.2000 Gjykata e Apelit Shkodër ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Në zbatim të vendimeve të mësipërme, Gjergj Bardhaj është arrestuar dhe nga dhomat e paraburgimit Lezhë ka ushtruar të drejtën e rekursit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke pretenduar ndër të tjera se mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk ka pasur asnjë tagër ta përfaqësojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe se pa dijeninë e tij, mbrojtësi është ankuar në Gjykatën e Apelit Shkodër. Për më tepër, ai thekson se në gjykatën e apelit, pavarësisht nga ankimi i bërë, mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk ka marrë pjesë ditën e gjykimit. Në rekurs pretendohet gjithashtu se edhe kualifikimi ligjor i veprës është bërë në kundërshtim me provat e administruara. Me vendimin nr.21, datë 7.1.2003 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit.

Pretendimi kryesor i kërkuarit në Gjykatën Kushtetuese, i cili është parashtruar edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, qëndron në faktin se gjykimi i kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit Shkodër është bërë pa pjesëmarrjen e një mbrojtësi, qoftë edhe të caktuar kryesisht nga gjykata, gjë që sipas tij, përbën proces të parregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, duke pasur parasysh edhe materialet e dosjes gjyqësore, çmon se në kuptimin që i jep procesit të rregullt ligjor neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ky pretendim i kërkuarit është i drejtë.

Gjykata Kushtetuese thekson se barazia e armëve dhe e shanseve dhe lidhur ngushtë me këto edhe parimi i kontradiktoritetit, janë elemente thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Mbi këtë bazë, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave, rëndësi të veçantë, merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë. Në çdo fazë të gjykimit, asnjëra nga palët nuk duhet ta ndiejë vehten në pozita haptazi të disfavorshme përballë kundërshtarit të tij. ¹

Për vetë natyrën e tyre, barazia e armëve dhe shanseve dhe për rrjedhojë vetë parimi i kontradiktoritetit, luajnë rol tepër të rëndësishëm sidomos në procesin penal, sepse në këtë rast, përballë personit të akuzuar për kryerjen e një vepre penale, normalisht është vetë shteti. Në këto kushte, kërkesat e mësipërme janë praktikisht në shërbim të mbrojtjes së personit të akuzuar, i cili gjatë gjithë procesit, deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga gjykata, prezumohet si i pafajshëm. Pikërisht për këtë arsye, shteti duhet të ndërmarrë të gjitha masat ligjore për t'i siguruar atij ose përfaqësuesit të tij pjesëmarrjen në proces dhe përmes saj edhe mundësinë e njohjes dhe deklarimit për të gjitha faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që i referohen akuzës së bërë. Gjykata Kushtetuese ka parasysh se edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar disa herë që garantimi i pjesëmarrjes së të akuzuarit ose mbrojtësit të tij në proces, në funksion të respektimit të kërkesave të mësipërme, vlen padyshim jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shqyrtimin e çështjes në shkallët e tjera të gjykimit, veçanërisht në rastet kur në këto gjykime parashikohet edhe zhvillimi i debatit me gojë. ²

¹ Shih vendimin e GjEDrNj, dt. 17.10.1993 në çështjen **Dombo Beheer B.V** kundër **Hollandës**, në A.274

² Ndër të tjera shih vendimin e GjEDrNj, dt. 19.02.1991, në çështjen **Alimena** kundër **Italisë**, në A.195-D

Në çështjen në gjykim, Gjykata Kushtetuese konstaton se të akuzuarit nuk i janë dhënë këto garanci në gjykimin e bërë në Gjykatën e Apelit Shkodër, duke u cenuar dukshëm e drejta e tij e mbrojtjes. Në fakt, rezulton se Kryetari i Kolegjit të Gjykatës së Apelit Shkodër, i ka dërguar njoftim për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes edhe Dhomës së Avokatisë Lezhë (mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata e shkallës së parë, i cili kishte bërë edhe ankimin kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë), por ky njoftim nuk ka asnjë konfirmim nga marrësi dhe nuk dihet nëse i është komunikur ose jo mbrojtësit të caktuar kryesisht. Pavarësisht nga kjo, Gjykata Kushtetuese çmon se edhe sikur njoftimi i bërë me këtë rast të ishte i rregullt, Gjykata e Apelit Shkodër, në funksion të respektimit të kërkesës për barazinë e armëve dhe të shanseve dhe të parimit të kontradiktoritetit, nuk duhej të kishte vendosur për zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit dhe të mbrojtjes, por duhej ta kishte shtyrë atë dhe të kishte marrë masat e duhura për të siguruar pjesëmarrjen e mbrojtësit, qoftë edhe të një tjetri të caktuar përsëri kryesisht.

Gjykata Kushtetuese çmon se nuk është i drejtë pretendimi tjetër i kërkuar për proces të parregullt ligjor nisur nga fakti se gjykimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë është bërë me mbrojtës të caktuar kryesisht, i cili pa dijeninë e tij ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është theksuar që në konceptin e mbrojtjes, përfshihet edhe e drejta e mbrojtësit të caktuar kryesisht për t'u ankuar kundër vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë.

Duke pasur parasysh se pretendimet e mësipërme janë ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë dhe se ato janë thelbësore për procesin e rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese çmon se kolegji penal i kësaj gjykate, në Dhomën e Këshillimit, duhej të kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe jo të vendosej mospranimi i rekursit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e 76 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.5, datë 1.2.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.21, datë 7.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes në Gjykatën e Apelit Shkodër.
 - Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
-

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 25.6.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë